



Republika e Kosovës
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Njësia për Politika dhe Monitorim të
Ndërmarrjeve Publike

Raporti i Performancës së Ndërmarrjeve Publike 2010



Tetor 2011



Hyrje

Më 13 Qershor të vitit 2008 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Ky Ligj është miratuar për ta sqaruar pronësinë e Ndërmarrjeve Publike. Në lidhje me NP-të qendrore (të radhitura në Shtojcën 1 të Ligjit të NP-ve) në pronësi të Republikës së Kosovës (d.m.th. publikut). Interesat pronësore të Republikës së Kosovës (d.m.th publikut), në një NP përfaqësohen nga aksionet dhe monitorohen nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, e cila Njësi është ruajtëse e certifikatave fizike që i përfaqësojnë ato aksione. Siç nënkuptohet nga vet emri, një ndërmarrje “publike” është ndërmarrje komerciale në pronësi të publikut, që do të thotë e të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Sipas Nenit 8 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike të Republikës së Kosovës, Qeverisë i kërkohet të raportohet në baza vjetore në Kuvend për performancën në sektorin e Ndërmarrjeve Publike dhe ky është raporti i parë në Kuvend, pasi ai për vitin 2009 nuk kishte arritur të shqyrtohet, si rrjedhojë e shpërndarjes së Kuvendit dhe zgjedhjeve të parakohshme. Ky raport në vete përmban edhe të dhënat e vitit 2009 që tregojnë për performancën e NP në vitin 2009.

Andaj, NJPMNP në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, e cila ka detyrë ligjore të monitorojë dhe raportojë për performancën e NP-ve në mënyrë individuale dhe kolektive, e ka përgatitur këtë raport, i cili fokusohet në:

- Performancën operative (rezultatet e arritura, efikasiteti, kualiteti i shërbimeve);
- Performancën financiare (qarkullimi i arritur, efikasiteti i shpenzimeve, profitabiliteti);
- Qeverisjen korporative (monitorimin e bordeve, llogaridhënia, planifikimi i biznesit);
- Perspektivën në të ardhmen (ndryshimet e tregut, investimet, rreziqet).

Raporti është përpiluar për të paraqitur një pikëpamje të qartë të performancës dhe perspektivës në sektorin e NP-ve dhe për të paraqitur tek parlamentarët dhe publiku çështjet me të cilat përballlet niveli i tanishëm i shërbimeve dhe zhvillimet që pasojnë për të përmirësuar qeverisjen korporative në sektor.

Sipas politikave qeverisëse dhe të monitorimit, çështjet kryesore që kanë të bëjnë me NP-të , e me qellim të përgaditjes së debatit në Qeveri, shqyrtohen nga Komisioni Ndërministror për Ndërmarrje Publike, i cili deri tani ka mbajtur tetëmbëdhjetë takime pune.

Ky Komision përfshin:

- Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (Kryesuesi)
- Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (Anëtar)
- Ministrinë e Energjisë dhe Minierave (Anëtar)
- Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (Anëtar)
- Ministrinë e Transportit dhe Post Telekomunikacionit (Anëtar)



Mirëpo, pas transferit të përgjegjësive dhe formimit të kabinetit të ri Qeveritar, ky komision me një vendim të Qeverisë ka pësuar ndryshime në përbërje si vijon:

- Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (Kryesuesi)
- Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (Anëtar)
- Ministrinë e Financave (Anëtar)
- Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (Anëtar)
- Ministrinë e Infrastrukturës (Anëtar)

Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Komisioni i Ministrave për Ndermarrje Publike vepron si aksionar i autorizuar në Takimet e Përgjithshme Vjetore të NP-ve dhe në ndonjë takim tjetër të aksionarëve. Ai këshillohet nga NJPMNP, e cila ndër të tjera, monitoron dhe raporton për performancën në sektorin e NP-ve.

Përpilimi dhe prezantimi i këtij raporti është një nga hapat e duhur për të përforcuar qeverisjen korporative në sektorin e NP-ve. Hapat e tjerë që janë ndërmarrë janë përshkruar në Pjesën e II-të të këtij raporti.

Ky raport nuk është i plotë dhe nuk merret me çështjet teknike të cilat janë me rëndësi vetëm për NP-të individuale. Informata më të hollësishme mund të merren nga raporti vjetor i bërë nga NP-të dhe faqja zyrtare e tyre në internet. Për të mirën e deputetëve dhe të publikut, ky raport e paraqet performancën e sektorit të NP-ve nga perspektiva e aksionarëve.

Ky raport përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e parë ofron një pikëpamje të performancës së sektorit të NP-ve në tërësi gjatë vitit 2010. Pjesa e dytë ka të bëjë me çështjet e qeverisjes korporative dhe përgjegjësitë që dalin nga implementimi i Ligjit mbi NP dhe thekson çështjet e përbashkëta afariste. Pjesa e tretë përmbledh rezultatet individuale dhe situatat në Ndërmarrjet individuale dhe tregon perspektivën për të ardhmen e tyre me një fokus në kërkesat e tyre të pritura për investime kapitale.

Politika pronësore e Qeverisë inkurajon participimin e sektorit privat në sektorët që aktualisht ofrohen nga Ndërmarrjet Publike, si dhe janë në vazhdim iniciativa të shumta nëpër sektorë për futjen e kapitali privat në atë publik, sidomos në sektorët: e aeroportit, ku tanimë ka përfunduar procesi i koncesionimit të tij përmes Partneritetit Publiko Privat, energjisë dhe telekomunikacionit, që po vazhdon të bëhet përmes shitjes së aksioneve përmes privatizimit.

NJPMNP nuk është e përfshirë në mënyrë direkte në ato iniciativa dhe progresi raportohet nga Komisionet Qeveritare për Privatizime.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë siguruar nga NP-të, përveç ku citohen referimet e veçanta. NJPMNP dëshiron të falënderojë drejtorët dhe stafin e NP-ve për bashkëpunimin e tyre.



Përmbledhja e Raportit

Hyrje.....	1
PJESA E PARË – Sqarim i Përgjithshëm i Performancës në Sektorin e Ndërmarrjeve Publike.....	7
Sfondi.....	7
Portofolio e Ndërmarrjeve Publike	8
Përkrahja Financiare nga Qeveria.....	9
Performanca Financiare e NP-ve Sipas Raporteve të Auditorit të Jashtëm.....	11
PJESA E DYTË – Qeverisja Korporative.....	13
Hyrje	14
Qeveria si Pronare në emër të Republikës së Kosovës.....	14
Politika Pronësore e Qeverisë.....	15
Qëllimi Korporativ dhe Aktiviteti Biznesor	15
Përzgjedhja dhe Emërimi i Drejtorëve	15
Struktura e Kapitalit	16
Performanca e Ndërmarrjeve	16
Dividenda.....	16
Subvencionet e Shtetit.....	16
Përfshirja e Sektorit Privat.....	17
Ushtrimi i të Drejtave të Pronësisë	17
Raportimi i NP-ve.....	17
Këshilla për Drejtorët e NP-ve dhe Sekretarët e Korporatës	18
Aplikimi (Zbatimi) dhe Pagesat për Grantet Kapitale dhe Subvencionet	18
Udhëzuesi për Drejtorët Joekzekutiv	18
Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative në Ndërmarrjet Publike.....	18
Konfliktet e Interesit.....	19
Punësimi në Ndërmarrje Publike Qendrore.....	19
Struktura e të Punësuarve Sipas Gjinisë	19
Struktura e të Punësuarve Sipas Shkallës së Edukimit Profesional	20
Vlerësimi i Bordit të NP-së.....	20
Roli dhe Përbërja e Bordit dhe Nënkomiteteve	20
Ligji i Ndërmarrjeve Publike	21
Pavarësia e Punës së Bordit të Drejtorëve	21
Veprimet Korrektuese	21
Inkasimi i të Hyrave për Shërbimet Komunale.....	22
PJESA E TRETË – Performanca dhe Perspektiva e NP-ve.....	23
Sektori i Komunikimeve	24
Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës.....	24
Sektori i Transportit	28
Hekurudhat e Kosovës.....	28
Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”.....	32
Sektori i Energjisë	36
Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu (KOSTT)	36
Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)	40
Sektori i Ujërave.....	45
Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina (KRU Prishtina).....	48
Kompania Rajonale e Ujësjellësit Radoniqi (KRU Radoniqi)	52
Kompanie Rajonale e Ujësjellësit Hidromorava (KRU Hidromorava)	56



Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor (KRU Hidroregjioni Jugor)	60
Kompania Rajonale e Ujësjellësit Radoniqi - Dukagjini (KRU Radoniqi - Dukagjini)	67
Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidrodrini (KRU Hidrodrini)	70
Kompania Rajonale e Ujësjellësit Mitrovica (KRU Mitrovica)	74
Ndërmarrja Hidro Ekonomike Ibër Lepenc (Ibër Lepenc)	78
Sektori i Mbeturinave	82
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë	83

Përmbledhja e Tabelave

Tabela 1 NP-të në Pronësi Qendrore	8
Tabela 2 NP-të në Pronësi Lokale	9
Tabela 3 Përkrahja Financiare nga Qeveria	10
Tabela 4 Rezultatet Financiare për Sektorin e NP-ve për vitin 2009 dhe 2010	11
Tabela 5 Struktura e të Punësuarve Sipas Gjinisë	19
Tabela 6 Struktura e të Punësuarve Sipas Shkallës së Edukimit Profesional	20
Tabela 7 Shkalla e Inkasimit për Shërbime Publike	22
Tabela 8 Shërbimet e Postës së Kosovës	25
Tabela 9 Rezultatet Financiare të PTK-së	26
Tabela 10 Struktura e të Punësuarve në PTK	27
Tabela 11 Performanca Operative	30
Tabela 12 Performanca Operacionale dhe Financiare në HK	30
Tabela 13 Struktura e Stafit në HK	31
Tabela 14 Performanca Operacionale në ANP	33
Tabela 15 Performanca Financiare në ANP	34
Tabela 16 Struktura e Stafit në ANP "Adem Jashari"	35
Tabela 17 Performanca Operacionale në KOSTT	37
Tabela 18 Përmbledhja e Performancës Financiare në KOSTT	38
Tabela 19 Struktura e të Punësuarve në KOSTT	39
Tabela 20 Performanca Operative në KEK	41
Tabela 21 Performanca Financiare në KEK	43
Tabela 22 Struktura e Stafit në KEK	44
Tabela 23 Treguesit Operativ në Sektorin e Ujërave	45
Tabela 24 Inkasimi në Ndërmarrjet e Ujërave në Kosovë	46
Tabela 25 Performanca Operative në KRU Prishtina	49
Tabela 26 Performanca Financiare në KRU Prishtina	50
Tabela 27 Struktura e Stafit në KRU Prishtina	51
Tabela 28 Performanca Operative në KRU Radoniqi	53
Tabela 29 Performanca Financiare në KRU Radoniqi	54
Tabela 30 Struktura e Stafit në KRU Radoniqi	55
Tabela 31 Performanca Operative në KRU Hidromorava	57
Tabela 32 Performanca Financiare në KRU Hidromorava	58
Tabela 33 Struktura e Stafit në KRU Hidromorava	58
Tabela 34 Performanca Operative	61
Tabela 35 Performanca Financiare në KRU Hidroregjioni Jugor	62
Tabela 36 Struktura e Stafit në KRU Hidroregjioni Jugor	63
Tabela 37 Performanca Operative në KRU Drini i Bardhë	65



Tabela 38 Performanca Financiare në KRU Drini i Bardhë	65
Tabela 39 Struktura e Stafit në KRU Drini i Bardhë	66
Tabela 40 Performanca Financiare në KRU Radoniq – Dukagjini	68
Tabela 41 Struktura e Stafit në KRU Radoniq - Dukagjini	69
Tabela 42 Performanca Operative në KRU Hidrodrini.....	71
Tabela 43 Performanca Financiare në KRU Hidrodrini	72
Tabela 44 Struktura e Stafit në KRU Hidrodrini.....	73
Tabela 45 Performanca Operative në KRU Mitrovica	75
Tabela 46 Performanca Financiare në KRU Mitrovica.....	76
Tabela 47 Struktura e Stafit në KRU Mitrovica	76
Tabela 48 Performanca Operative në NH Ibër Lepenc	79
Table 49 Performanca Financiare në NH Ibër Lepenc	79
Tabela 50 Struktura e Stafit në Ibër Lepenc	80
Tabela 51 Performanca Operative në KMDK.....	84
Tabela 52 Performanca Financiare në KMDK.....	84
Tabela 53 Struktura e Stafit në KMDK	85

Përmbledhja e Figurave

Figure 2 Prodhimi i Energjisë 2009 - 2010	42
Figure 3 Prodhimi i Qymyrit 2009 - 2010.....	42
Figure 4 Faturimi dhe Inkasimi si % e faturimit 2009 - 2010.....	42



Lista e Shkurtesave

NP	Ndërmarrje Publike
NJPMNP	Njesia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
PPP	Partneriteti Publiko Privat
AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
KRU	Kompania Regjionale e Ujësjetës
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
ZRRUM	Zyra e Rregullatorit për Uje dhe Mbeturina
KE	Komisioni Evropian
USAID	United States Agency for International Development
BE	Bashkimi Evropian
IFC	International Finance Corporation
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni I Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
TPV	Takimi i Përgjithshëm Vjetor
LNP	Ligji mbi Ndërmarrje Publike
ANP	Aerporti Ndërkombëtar I Prishtinës
RTK	Radio Televizioni I Kosoves
BB	Banka Botërore
OST (KOSTT)	Operatori i Sistemit të Transmisionit
ZKE	Zyrtari Kryesor Ekzekutiv
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar
TiK	Telekomi i Kosovës
ART	Autoreteti Rregullativ I Telekomunikacionit
BD	Bordi I Drejtoreve
PF	Pasqyrat Financiare
PB	Plani I Biznesit
HK	Hekurudhat e Kosoves
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
SEETO	South Eastern Europe Transport Organization
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development
SWOT	Strength, Weakness, Opportunity, Threat
NJB	Njësi Biznesi
KA	Komisioni i Auditimit
UD	Ushtrues Detyre
NJO	Njësia Operative
AB	Auditori i Brendshëm
AJ	Auditori i Jashtëm
ZRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
KfW	Kreditanstalt Für Wiederaufbau (German Development Bank)
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve



PJESA E PARË – Sqarim i Përgjithshëm i Performancës në Sektorin e Ndërmarrjeve Publike

Sfondi

Duke u bazuar në Ligjin e Ndërmarrjeve Publike të vitit 2008, drejtorët joekzekutiv të të gjitha NP-ve qendrore janë zgjedhur përmes një procesi transparent, të hapur dhe konkurrues. Ata janë emëruar zyrtarisht nga Qeveria në Dhjetor të vitit 2008, ndërsa kanë filluar me pozitë të tyre në Shkurt dhe Maj 2009.¹ Ngjashëm, autoritetet komunale të cilat janë aksionare në NP-të lokale i emërojnë drejtorët joekzekutiv të atyre ndërmarrjeve. Secili bord i NP-ve përfshin në vete edhe Kryeshefin Ekzekutiv, apo Zyrtarin Kryesor Ekzekutiv, që ndonjëherë referohet si Drejtor Menaxhues.

Gjatë rishikimit të performancës së NP-ve është me rëndësi të kemi parasysh dy faktorë të tjerë historik.

Së pari, NP-të që nuk janë të themeluara sot, kanë filluar me situatat e trashëguara nga viti 1999 dhe që atëherë janë përballur me ndryshime të shumta. Njëri nga problemet me të cilat përballen disa NP është paqartësia e kostos reale të disa aseteve kryesore. Këto çështje janë trajtuar në raportin e auditimit dhe raporte të tjera, dhe për këtë arsye nuk janë diskutuar më tutje në këtë raport. Gjithashtu, secili lexues është në dijeni që ka pasur shumë ndryshime institucionale në periudhën 1999-2008 deri atëherë kur të gjitha NP-të ishin nën administrimin e ish AKM.

Së dyti, ripozicionimi i NP-ve në kontekst të ekonomisë së tregut në Kosovë. Këta faktorë i shpjegojnë disa nga problemet me të cilat përballen NP-të, në veçanti niveli i investimeve të ulëta dhe ritmi i ndryshimeve të mundshme.

¹ Si përjashtim kanë qenë bordet e PTK-së dhe KEK-ut, të cilat kanë marrë detyrën e tyre në shkurt të vitit 2009.



Portofolio e Ndërmarrjeve Publike

Siç ceket në Listën 1 të Ligjit mbi Ndërmarrje Publike të vitit 2008, portofolio e tanishme e NP-ve qendrore përbëhet nga 15 ndërmarrje publike (Tabela 1).²

Tabela 1 NP-të në Pronësi Qendrore

Sektori	Ndërmarrja Publike	Faqe
Komunikimet	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A. (PTK)	24
Energjia	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu (KOSTT) Sh.A	36
	Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. (KEK)	40
	NPH Ibër Lepenci Sh.A	78
Transporti	Hekurudhat e Kosovës Sh.A. (HK)	28
	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" Sh.A (ANP)	32
Mbeturinat	Kompania e Kosovës për Menaxhimin e Deponive Sh.A (KMDK)	83
	Kompania Rajonale e Ujësullësit Prishtina Sh.A (Prishtinë)	48
	Kompania Rajonale e Ujësullësit Radoniqi Sh.A (Gjakovë)	52
	Kompania Rajonale e Ujësullësit Hidromorava Sh.A (Gjilan)	56
	Kompania Rajonale e Ujësullësit Hidroregjioni Jugor Sh.A (Prizren)	60
	Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë Sh.A	64
	Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A	67
	Kompania Rajonale e Ujësullësit Hidrodrini Sh.A (Pejë)	70
	Kompania Rajonale e Ujësullësit Mitrovica Sh.A (Mitrovicë)	74
	NPH Ibër Lepenci Sh.A	78

Gjithashtu, janë edhe 16 Ndërmarrje Publike në pronësi komunale (Tabela 2):

Edhe pse Qeveria ka ofruar mbështetje financiare për disa nga këto Ndërmarrje Publike, Komunitat mbajnë përgjegjësi ekskluzive për menaxhimin e tyre dhe raportimin për performancën e tyre para asambleve komunale, dhe si rrjedhojë këto raportime nuk janë paraqitur në këtë raport.

² Sh.A. Ibër Lepenci është në dy sektorë.



Tabela 2 NP-të në Pronësi Lokale

Sektori	Ndërmarrja Publike Lokale
Ngrohtorja	Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A. (Prishtinë)
	Ngrohtorja e Qytetit Sh.A. (Gjakovë)
Tregtia	NP Tregu, Mitrovicë
Strehimi	Ndërmarrja Publike Banesore, Prishtinë
Uji dhe mbeturinat	Kompania Rajonale e Ujësjellësit Bifurkacioni Sh.A. Ferizaj
	Kompania Rajonale e Mbeturinave Ambienti Sh.A. Pejë
	Kompania Rajonale e Mbeturinave Çabrati Sh.A. Gjakovë
	Kompania Rajonale e Mbeturinave Ekoregjioni Sh.A, Prizren
	Kompania Rajonale e Mbeturinave Higjiena Sh.A. Gjilan
	Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastërtia Sh.A. Ferizaj
	Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi Sh.A Prishtinë
	Kompania Rajonale e Mbeturinave Uniteti Sh.A. Mitrovicë
	Kompania e Mbeturinave JKP Standard, Mitrovicë
	Kompania e Mbeturinave JKSP Zveçan
	Kompania e Ujësjellësit dhe Mbeturinave Ibri, Zubin Potok
	Kompania e Ujësjellësit dhe Mbeturinave 24 Nëntori, Leposaviq

Përkrahja Financiare nga Qeveria

Disa nga NP-të varen nga transferet e Qeverisë në formë të subvencioneve direkte, granteve për investime kapitale dhe kredive si në rastin e KEK-ut. Subvencionet definojnë si përkrahje financiare nga Qeveria për të paguar për shërbimet operative, siç janë humbjet e bëra nga udhëtarët në shërbimet hekurudhore në rastin e Hekurudhave të Kosovës, blerja e mazutit për ngrohtore, mbulimi i shpenzimeve të energjisë për ujësjellësit (kur KRU-të nuk kanë mundësi pagese, apo derivateve për mbeturina (kur KRM s'ka mundësi pagese, pagesa-subvencionimi i shpenzimit të ujit për pjesën matanë Ibrit dhe pagesat për të mbuluar koston e ofruar për të varfrit (që referohen si "raste sociale"), por deri tani rastet sociale mbulohen vetëm për energji. Ndërsa, në anën tjetër grantet për investime kapitale ndërlihen me projektet specifike të NP-së për shpenzime kapitale.




Figura 1 Mbështetja Financiare për NP-të



Tabela 3 Përkrahja Financiare nga Qeveria

Ndërmarrja Publike Qendrore dhe Lokale	2009		2010	
	€000		€000	
	Investime Kapitale	Subvencione	Investime Kapitale	Subvencione
PTK	0	0	0	0
RTK	0	0	0	10,464
KEK	300	68,184	0	33,520 ³
KOSTT	14,079	0	8,339	0
Hekurudhat e Kosovës	3,044	500	2,682	500
ANP “Adem Jashari”	0	0	0	0
Sh.A. Ibër Lepenc	0	0	0	0
Ndërmarrjet e Ujërave dhe Hedhurinave	3,108	776	2,651	587
Ngrohja Qendrore	482	1,933	449	1,403
Gjithsejtë sipas kategorive	21,013	71,393	14,121	46,474
Gjithsejtë NP-të Qendrore dhe Lokale	92,406		60,595	

Bazuar në politikat e Qeverisë si dhe projeksionet buxhetore, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) dhe sygjerimet e Fondit Monetar Nderkombëtar, subvencionet ndaj ndërmarrjeve publike kanë trendin e rënies nga 2009 për 35%. Ky trend i zvogëlimit të mbështetjes financiare për NP-të vjen si rezultat i ngritjes së qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjeve dhe si rrjedhojë do të mundësohet që të krijohet një pavaresi më e lartë financiare në ndërmarrjet publike.

³ Në shumën e subvencioneve për KEK për vitin 2009 dhe 2010 është përfshirë edhe subvencioni i energjisë elektrike për raste sociale me vlerë 4,500,000.00€.



Performanca Financiare e NP-ve Sipas Raporteve të Auditorit të Jashtëm

Në tabelën e mëposhtme është një përmbledhje e përgjithshme e indikatorëve kyq financiar të të gjitha ndërmarrjeve publike të përfshira në Ligjin Mbi Ndërmarrje Publike.

Tabela 4 Rezultatet Financiare për Sektorin e NP-ve për vitin 2009 dhe 2010

NP	2010			2009		
	Të hyrat neto	Kostot	Fitim (Humbja)	Të hyrat neto	Kostot	Fitim (Humbja)
	€ 0	€ 0	€ 0	€ 0	€ 0	€ 0
PTK	154,049	120,653	33,396	157,783	113,406	44,377
RTK	0	0	0	0	0	0
KEK	238,827	224,679	14,148	237,704	232,721	4,983
KOSTT	22,725	19,257	3,468	21,257	14,493	6,764
Hekurudhat e Kosovës	7,928	7,993	-65	6,102	6,457	-355
ANP "Adem Jashari"	28,064	21,886	6,178	28,989	18,756	10,233
Komp. e Menaxh. të Deponive	1,116	2,076	-960	1,095	1,580	-485
HS Ibër Lepenc	5,379	7,713	2,334 ⁴	3,563	7,107	-3,544
Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë	170	244	-74	174	237	-63
Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini	810	839	-29	760	791	-31
KRU Hidrodrini (Pejë)	3,003	3,239	-236	2,560	3,138	-578
KRU Hidromorava (Gjilan)	1,719	2,105	-386	1,445	1,522	-77
KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)	2,908	3,441	-533	2,756	3,326	-570
KRU Mitrovica	3,248	3,630	-382	3,304	3,586	-282
KRU Prishtina SH.A	11,610	13,550	-1,940	10,134	12,465	-2,331
KRU Radoniqi (Gjakovë)	2,795	3,303	-508	2,646	3,208	-562
TOTALI për NP-të qendrore	484,351	434,608	52,077	480,272	422,793	57,479

Të hyrat totale në sektorin e NP-ve qendrore për vitin 2010 ishin 484.4 milionë Euro, apo për 1% më i lartë se në vitin 2009, ndërsa shpenzimet (kostot) e përgjithshme ishin 434.6 mil € apo 1.02% më të larta se në vitin 2009. Dhe kjo sjellë një rezultat të përgjithshëm të NP në vlerë 52.1 Milion Euro fitim financiar.

⁴ Kjo ndërmarrje është financiarisht stabile, por për arsye të shpenzimit të amortizimit, ndërmarrja raporton humbje në fund të vitit.



Katër Ndërmarrje Publike raportojnë të kenë fitim në fund të vitit 2010, por që ky fitim në dy ndërmarrjet (Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”) nga e cilat është tërhequr dividenda dhe fitimi financiar vjetor ishte me i vogël që ishte si rrjedhojë e zvogëlimit të të hyrave nga interesi bankar që këto dy ndërmarrje kishin nga këto mjete të deklaruar dhe transferuar në llogari të aksionarit, dhe shtatë nga to raportohet t’i kenë zvogëluar dukshëm humbjet në krahasim me vitin 2009. Ndërsa, edhe HS Ibër Lepenc duket të jetë financiarisht stabile edhe pse është në humbje (ka shënuar rënie) si rezultat i shpenzimeve të mëdha të amortizimit, por që financiarisht është e qëndrueshme dhe nuk pranon subvencione dhe grante nga Qeveria.

Rezultatet nga tabela e mësipërme dalin nga raportet e auditorëve të jashtëm, sipas të cilave, por edhe sipas standardeve të kontabilitetit, subvencionet e Qeverisë trajtohen si të hyra.

Është e një rëndësie jetike për Qeverinë e Kosovës performanca e ndërmarrjeve publike e sidomos respektimi i ligjshmërisë gjatë funksionimit të tyre.

Me gjithë të priturat më të mëdha, vlerësimet mbi opinionin e auditorëve të jashtëm janë inkurajuese, sepse nga 15 NP qendrore të audituara, shtatë nga ato kanë vlerësimin më të lartë nga Auditori i Jashtëm të vlerësuar si të *Pakualifikuara*, ndërsa shtatë të tjera si të *kualifikuara me theksim të qësjës* dhe një me opinion të kundërt.

Rezultatet operative dhe financiare të secilës NP dhe në përputhje me Raportet të Auditorëve të Jashtëm dhe zyreve rregullatorë paraqiten dhe diskutohen në Pjesën III të këtij raporti.



PJESA E DYTË – Qeverisja Korporative



Hyrje

Viti 2009 ishte viti i parë kur Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në kuadër të Ministrise së Ekonomise dhe Financave filloi funksionin e saj, ndërsa pavarësisht nga kufizimi i kapaciteteve, Njësia ka bërë përpjekje ta përmbushë rolin e saj të monitorimit dhe vlerësimit, si dhe ta përpilojë këtë raport. Performanca e përgjithshme e Ndërmarrjeve Publike shtjellohet në Pjesën e Parë dhe performanca e ndërmarrjeve individuale shtjellohet në Pjesën III. Kjo pjesë (Pjesa II) raporton për aspektet e tjera të punës së Njesisë së NP-ve, veçanërisht punën që është bërë për ta përforcuar qeverisjen korporative.

Çështjet kryesore në të cilat Njësia e NP-ve ka punuar janë:

- Përforcimi i raportimit të rregullt;
- Këshilla për drejtorët e NP-ve dhe sekretarët e korporatës;
- Pjesëmarrja në takime të bordit të NP-së;
- Pregaditja dhe procedimi i pagesave të subvencioneve dhe granteve kapitale;
- Përpilimi dhe shpërndarja e udhëzuesit për drejtorët e NP-së;
- Përpilimi dhe shpërndarja e modelit të kodit të etikës dhe qeverisjes korporatave pas aprovimit nga aksionari;
- Monitorimi i Bordit; dhe
- Rishikimi i përshtatjes me kërkesat ligjore.

Në mënyrë që t'i vëmë këto çështje në kontekst, në vazhdim është politika e Qeverisë për pronësinë e Ndërmarrjeve.

Qeveria si Pronare në emër të Republikës së Kosovës

Qeverisja korporative është korniza nga e cila kërkohet të sigurojë që secila ndërmarrje është e drejtuar dhe e menaxhuar në mënyrë të drejtë dhe efikase, duke zbatuar ligjet dhe praktikën e mira dhe me kalimin e kohës kjo i maksimizon kthimet në fondet e aksionarëve. Në një NP, objektiva e biznesit është pak më ndryshe se në një ndërmarrje private, sepse nga entiteti publik pritet t'i përmbush objektivat e caktuara të politikave të vendosura nga Qeveria, të cilat mund të mos jenë të lidhura me maksimizimin e kthimeve në investime, por ndërlidhen me objektivat zhvillimore ekonomike dhe sociale⁵. Por, në çdo ndërmarrje, politikën e qeverisjes korporative duhet t'i vendosin aksionarët në qendër të afarizmit, qofshin ata privatë apo vetë Qeveria.

⁵ Për shembull: arritja e furnizimit universal të ujit të pijshëm sa më lirë që është e mundur.



Politika Pronësore e Qeverisë

Parimi kryesor i qeverisjes së mirë korporative është që ndërmarrja duhet të udhëhiqet nga një bord efektiv, i cili është përgjegjës në mënyrë kolektive për suksesin e ndërmarrjes. Në rastin e një NP-je, Qeveria e lejon bordin të ushtrojë përgjegjësitë e tij dhe respekton pavarësinë e tij. Qeveria nuk duhet të përfshihet në menaxhimin e NP-ve dhe duhet t'ua lejojë autonominë e plotë operative për të arritur objektivat e tyre të definuara. Në mënyrë që Qeveria të marrë këtë qëndrim “të mbajë distancë”, ajo ka zhvilluar një politikë që definon objektivat e përgjithshme të pronësisë shtetërore, rolin e shtetit në qeverisjen korporative të NP-ve dhe se si ajo do t'i implementojë politikën e saj.

Politika e përgjithshme e Qeverisë për pronësinë e ndërmarrjeve i ka tetë komponenta:

- Qëllimet korporative dhe aktivitetet biznesore;
- Përzgjedhja dhe emërimi i Drejtorëve;
- Takimet e Përgjithshme Vjetore;
- Struktura e kapitalit;
- Performanca e Ndërmarrjes;
- Dividenda;
- Subvencionet shtetërore; dhe
- Përfshirja e sektorit privat.

Politikat e përgjithshme të lartëpërmendura zbatohen për të gjitha NP-të. Përveç këtyre politikave mund të ketë edhe politika shtesë që mund të jenë specifike për sektorin apo territorin.

Qëllimi Korporativ dhe Aktiviteti Biznesor

Qëllimi korporativ dhe aktivitetet biznesore të ndërmarrjes janë të definuara nga Qeveria dhe duhet të shtrihen vetëm në ato aktivitete të specifikuar nga Qeveria. Ndërmarrja nuk duhet të ndërmarrë veprime të reja jashtë qëllimeve të caktuara korporative; dhe brenda qëllimeve të saj korporative nuk duhet t'i zgjerojë aktivitetet e reja, përveç nëse një zgjerim i tillë është i nevojshëm në mënyrë objektive për të ruajtur ose zgjeruar vlerat e aktivitetëve ekzistues.

Përzgjedhja dhe Emërimi i Drejtorëve

Ky proces është i vendosur me Ligjin e NP-ve. Procesi është kryer nëpërmjet konkursit publik e transparent, ndërsa komisionet rekomanduese kanë rekomanduar listën përzgjedhëse për Qeverinë me kandidatët më të mirë të mundshëm, nga të cilat lista, Qeveria ka emëruar bordet për NP qendrore.

Qeveria pret që bordi, brenda kornizës së misionit, objektivave dhe planit të biznesit të ndërmarrjes, ta drejtojë ndërmarrjen ashtu siç pritet nga ajo. Qeveria e mban bordin llogaridhënës për performancë dhe kjo bëhet nga monitorimi i saj përmes Njësisë së NP-ve dhe Takimit të Përgjithshëm Vjetor (TPV).



Struktura e Kapitalit

Struktura e kapitalit të një ndërmarrje duhet të jetë adekuate për nevojat e biznesit dhe konsistente me normat ndërkombëtare për industri. Andaj, duhet të rishikohet në baza të rregullta nga Qeveria, bordi i ndërmarrjes dhe Njësia e NP-ve.

Kur në mënyrë objektive duket e nevojshme, kontributet e reja për kapitalin e aksioneve të ndërmarrjes do të jenë të mundshme nga Qeveria përmes procesit normal të buxhetit të shtetit, siç ceket në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

Performanca e Ndërmarrjeve

Qëllimi i Qeverisë nuk është të investojë në një NP për të fituar një normë tregu të kthimit; ky është qëllim i biznesit të sektorit privat. Qeveria investon aty ku e sheh të nevojshme për interesat më të mira të qytetareve dhe që është e përcaktuar me ligjin për ndarje buxhetore. Megjithatë, Qeveria pret që bordi dhe menaxhmenti i ndërmarrjes t'i maksimizojnë vlerat e investimeve të tyre. Të priturat për performancën janë të vendosura në planin e biznesit të ndërmarrjes. Kjo komponent është shtjelluar edhe në pjesën e parë dhe individualisht për secilën NP në pjesën e tretë.

Duke u mbështetur në aksionet e saj në ndërmarrje, Qeveria ka kërkesa specifike të performancës. Këto kërkesa kanë të bëjnë me çështjet operative, siç është niveli i prodhimit, kualiteti dhe besueshmëria e shpërndarjes së shërbimeve dhe mbulimi gjeografik i shërbimeve. Në terma financiar kjo mund të shprehet si “norma e kërkuar e kthimit” (që nuk është e njëjtë sikurse maksimizimi i normës së kthimit) që do të thotë se ndërmarrja fiton profit dhe ka bazë komerciale.

Dividenda

Nëse ndërmarrja publike paraqet fitim, nga bordi pritet, në këshillat e ekipit të menaxhmentit, të përcaktojë se sa prej atij fitimi duhet të mbetet për ri-investime dhe sa duhet të paguhet për dividendë. Gjatë vitit 2009 - 2010 bordi i drejtorëve të PTK-së ka deklaruar dhe paguar dividendë për aksionarin në vlerë prej 280 milionë Euro, si dhe bordi i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, gjithashtu ka deklaruar dhe paguar dividend në vlerë 10 milionë Euro për vitin 2010.

Subvencionet e Shtetit

Qeveria duhet të ketë parasysh sigurimin e subvencioneve në Ndërmarrje në rrethana të caktuara nëse kjo është e përcaktuar me ligjin për ndarje buxhetore. Ja disa shembuj:

- a) Qeveria kërkon nga ndërmarrja të sigurojë shërbime ose nivel të shërbimeve, që në rrjedhën normale të biznesit, ndërmarrja nuk do ta bëjë atë. Varësisht nga lloji dhe kohëzgjatja e shërbimeve, Qeveria do të përcaktojë nëse subvencionet do të paguhen si shërbime “pro rata” (në proporcion) apo si një shumë fikse;
- b) Ndërmarrja është duke siguruar shërbime dhe është duke arritur caqet e efikasitetit operativ, mirëpo të hyrat nuk i mbulojnë shpenzimet. Nëse, për të mbuluar



shpenzimet, ndërmarrja dëshiron të rris tarifat e saj, por Autoriteti Rregullativ vendos mos të sanksionojë rritjen e tarifave në nivelin e dëshiruar nga ndërmarrja, Qeveria mund të sigurojë subvencione për ta mbuluar “boshllëkun”; ose

- c) Granti kapital do të ishte i nevojshëm drejt financimit të investimeve të mëdha në rast kur: (i) asetet fizike ekzistuese janë pranë përfundimit të jetës së tyre ekonomike; ose (ii) shfrytëzimi i teknologjisë së re do ta zvogëlojë ndjeshëm koston e operimit; ose (iii) kapaciteti ekzistues është i pamjaftueshëm dhe kërkohen investime për t’i zgjeruar kapacitetet.

Përfshirja e Sektorit Privat

Qeveria është përcaktuar për ekonomi të lirë të tregut dhe si rezultat i kësaj inkurajohet përfshirja e sektorit privat në mënyrë aktive në ndërmarrje publike, ku një përfshirje e tillë do të sigurojë përfitim të përgjithshëm për popullin e Kosovës, duke pas parasysh:

- a) efikasitetin dhe kualitetin e shërbimeve të shpërndara nga ndërmarrja;
- b) ndikimin e përgjithshëm ekonomik të strukturave alternative të pronësisë;
- c) kapaciteti i buxhetit të Qeverisë për të bërë investime në ndërmarrje që janë të nevojshme për të shpërndarë shërbime në të ardhmën; dhe
- d) natyra e konkurrencës brenda sektorit në të cilin ndërmarrja operon.

Përfshirja e sektorit privat në sektorin publik mbështetet në Ligjin mbi Ndërmarrje Publike (Neni 9) dhe në ligjin për Partneritetet Publiko Private dhe konform tyre është kryer procesi i futjes së kapitalit privat në ANP “Adem Jashari” përmes koncesionimit dhe janë në vazhdim proceset e privatizimit të PTK-së, Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim të Energjisë (KKDFE,) dhe koncesinimi i Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK).

Ushtrimi i të Drejtave të Pronësisë

Për t’i ushtruar të drejtat e pronësisë, Qeveria përmes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ka themeluar Njësine për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, që do të ndihmojë Ministrin dhe Qeverinë për ushtrimin e përgjegjësive që iu jep ligji mbi NP-të; të koordinojë rrjedhën e informatave nga të gjitha NP-të, të monitorojë performancën e tyre, të këshillojë Qeverinë dhe NP-të për çështjet që ndikojnë në performancën e tyre dhe të përgatis raportin për raportim të Qeverisë - MZHE, para publikut – në Kuvendin e Kosovës, për performancën e NP-ve, në mënyrë individuale dhe kolektive. NJPMNP ka zbatuar dhe vazhdon t’i zbatojë këto detyra.

Raportimi i NP-ve

Nga të gjitha NP-të qendrore kërkohet të dorëzojnë raportin tremujor në Njësine e NP-ve. Gjatë vitit 2010, të gjitha NP-të i kanë dorëzuar këto raporte. Shumica e ndërmarrjeve kanë përdorur format e përcaktuara nga to, të mbështetura në nenin 31 të Ligjit mbi Ndërmarrje Publike.



Këshilla për Drejtorët e NP-ve dhe Sekretarët e Korporatës

NJPMNP ka ofruar këshilla dhe përkrahje për drejtorët e NP-ve dhe sekretarët e korporatës. Gjatë vitit 2010 një varg çështjesh janë referuar në Njësinë e NP-ve, që kanë të bëjnë me proceset e reja lidhur me qeverisjen korporative siç janë: trajnimet për sekretarët e kompanive publike dhe sekretarët e bordeve të drejtorëve e që kanë të bëjnë me komunikimin me aksionarin, përcjellja e punës së mbledhjeve të bordeve të drejtorëve, si dhe format e raportimit ashtu siç është parashikuar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike si dhe trajnimi i organizuar për Auditorët e Brendshëm të NP-ve me qëllim të rritjes së kontrollit të brendshëm.

NJPMNP ka përmbushur obligimet që dalin nga neni 17.6 të Ligjit mbi NP mbi trajnimin e Bordeve të Drejtorëve. Kështu, me bashkëpunimin e USAID-it dhe Bankën Botërore (IFC) është bërë trajnimi i tyre gjatë vitit 2010, dhe kështu ka vazhduar edhe gjatë vitit 2011.

Aplikimi (Zbatimi) dhe Pagesat për Grantet Kapitale dhe Subvencionet

NJPMNP përpunon (proceson) aplikimin dhe pagesat e granteve kapitale dhe subvencioneve, për t'u siguruar që ato fonde aplikohen për qëllimet e dedikuara. Për ta lehtësuar këtë, NJPMNP ka një marrëveshje të monitorimit me secilën NP përmes së cilës ata i dorëzojnë raportet tremujore në Njësinë e NP-ve për rishikim. Gjatë vitit 2010 NJPMNP ka procesuar shumat e paguara siç janë listuar në Tabelën 3, dhe të cilat pagesa janë të lëshuara në bazë të kontratës, faturave, dhe raporteve mbi kryerjen e shërbimeve, gjegjësisht furnizimeve.

Udhëzuesi për Drejtorët Joekzekutiv

Siç është cekur në hyrje të këtij raporti, viti 2009 ishte vit inaugurimi për bordet e reja të drejtorëve. Gjatë vitit 2009 ka qenë evidente për Njësinë e NP-ve, që disa persona të emëruar si drejtorë të një NP-je nuk e kanë kuptuar plotësisht rolin dhe përgjegjësinë e asaj pozite. Andaj, NJPMNP ka përpiluar një broshurë *Udhëzues për t'u bërë Drejtor i Ndërmarrjeve Publike (joekzekutiv)*. Ky dokument, i cili e përforcon modelin e Kodit (*shih në vijim*), sqaron se çka pritet nga një drejtor i NP-së dhe, gjithashtu çka mund të pret individit. Kjo broshurë është botuar dhe u është shpërndarë të gjithë drejtorëve të NP-ve gjatë vitit 2010 dhe, gjithashtu është në dispozicion të atyre që dëshirojnë të bëhen drejtorë joekzekutiv në një Ndërmarrje Publike.

Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative në Ndërmarrjet Publike

Neni 35.4 i Ligjit të NP-ve e obligon Ministrin “të shpallë një model të kodit të etikës dhe qeverisjes korporative për përdorim nga NP-të dhe secila NP duhet të sigurohet që kodi i tyre është konsistent me këtë model të kodit”. Një model i kodit të etikës është përgatitur dhe është përdorur si bazë për sigurimin e angazhimit të drejtorëve të ri të NP-ve për ta zbatuar kodin, të gjitha rregulloret dhe legjislacionin ekzistues. Të gjithë drejtorët e kanë nënshkruar me kohë deklaratën për ta respektuar kodin dhe ndaj të gjithë atyre që nuk e kanë respektuar këtë kod, vlerësimi dhe vendimi për ta do të merret gjatë vlerësimit të bordeve nga Aksionari.



Megjithatë, është paraqitur nevoja për një kod më gjithëpërfshirës dhe më bashkëkohorë dhe për këtë arsye është përpiluar një model i ri i Kodit nga NJPMNP. Modeli i ri i *Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative* është botuar nga MEF dhe është shpërndarë tek të gjitha NP-të.

Në pajtim me Nenin 35.1 të Ligjit të NP-ve, ky model i Kodit:

- (a) E angazhon NP-në për standardet më të larta të sjelljes korporative dhe praktikave biznesore;
- (b) Është i detajuar në mënyrë të mjaftueshme për të dhënë udhëzime të qarta për sjelljet që priten nga të gjithë drejtorët, zyrtarët, punonjësit dhe këshilltarët/konsulentët profesionalë të NP-së;

Konfliktet e Interesit

Njëra nga çështjet etike që përmendet në *Udhëzuesin Për t'u bërë Drejtor i Ndërmarrjes Publike* dhe në *Modelin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative* është deklarimi dhe mënjanimi i konfliktit të interesit.

Nga të gjithë personat e emëruar drejtor të një NP-je kanë nënshkruar zotimin për respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative. Mosrespektimi i Kodit nuk do të tolerohet dhe do të ndërmerren veprime të mëtutjeshme përmirësuese sipas nevojës. Rastet e tilla të paraqitura janë adresuar tek institucionet përgjegjëse të cilat përcaktojnë konfliktet e interesit.

Punësimi në Ndërmarrje Publike Qendrore

Për ofrimin e shërbimeve publike kualitative ndaj qytetarëve të Kosovës si dhe funksionimit normal të ndërmarrjeve publike qendrore janë të angazhuar dhe japin kontributin e drejtpërdrejt 14463 të punësuar të cilët me pagat e tyre e ndihmojnë mirëqenien e familjes së tyre për afër 14 mijë familje me afër 75 mijë anëtar të këtyre familjeve.

Struktura e tyre profesionale, gjinore, dhe nacionale është e paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Struktura e të Punësuarve Sipas Gjinisë

Tabela 5 Struktura e të Punësuarve Sipas Gjinisë

	Nr. i punëtoreve (M)	Nr. i punëtoreve (F)	Gjithsejtë
2009	12478	1733	14211
2010	12725	1738	14463

Nga tabela e mësipërme kuptohet se nga të punësuarit e tërësishëm, 12,042 apo 88% janë meshkuj dhe 1,607 apo 12% janë femra. Kjo struktura në të ardhmën rekomandohet që të ndryshon në të mirë të rritjes së të punësuarve nga gjinia femërore. Duhet cekur që veprimtaria e ndërmarrjeve publike në Kosovë në të shumtën e rasteve e përcakton gjininë pjesëmarrëse në punë siç janë divizionet e mihes apo prodhimit të ujit apo sigurimin e deponive të mbeturinave. Andaj numri i paraqitur më lartë ndikohet nga faktorët e përmendur.



Struktura e të Punësuarve Sipas Shkallës së Edukimit Profesional

Tabela 6 Struktura e të Punësuarve Sipas Shkallës së Edukimit Profesional

	Përgatitje superiore	Përgatitje të lartë shkollore	Përgatitje të mesme shkollore	Përgatitje të ulët shkollore	Gjithsejtë
2009	1810	702	8801	2898	14211
2010	1974	720	8834	2935	14463

Tabela e mësipërme jep strukturën e të punësuarve sipas përgatitjes shkollore. Nga numri i tërësishëm, 19% e punësuarve kanë përgatitje të lartë superiore, 60% përgatitje të mesme shkollore, dhe 21 % e tyre kanë përgatitje të ulët shkollore.

Vlerësimi i Bordit të NP-së

Sipas Ligjit të Ndërmarrjeve Publike, secili bord duhet ta bëjë vetëvlerësimin; dhe gjithashtu kërkon nga NJPMNP të vlerësojë performancën e bordit të NP-ve. Procesi i vetëvlerësimit është në pajtueshmëri me praktikat më të mira botërore në sektorët publikë. Megjithatë, kjo është diçka e re për sektorin e NP-ve në Kosovë dhe në mënyrë që të ndihmohen bordet e NP-ve në këtë proces të panjohur për ta, Njësia e NP-ve ka përgatitur një pyetësor dhe e ka shpërndarë tek të gjitha bordet. Gjithashtu, janë mbajtur edhe takime me drejtorë të NP-ve dhe me të gjithë sekretarët e bordeve për ta diskutuar pyetësorin. Bordet i kanë dorëzuar vetëvlerësimet e tyre me kohë në Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Në pjesën individuale të NP-ve, në Pjesën III të këtij raporti, sigurohen informata për numrin e takimeve të bordit që janë mbajtur në vitin 2010, për formimin e komiteteve të bordit, dhe një përmbledhje për punën e bordit. Në përgjithësi, bordet e NP-ve kanë bërë përpjekje për një paraqitje të mirë për performancën e tyre. Në vlerësimin e Bordeve të drejtorëve të ndërmarrjeve publike, NJPMNP është ndihmuar edhe nga konsulenca ndërkombëtare për vlerësimin e efektshmërisë së punës së bordeve të drejtorëve të përcaktuar sipas nenit 28.3 të Ligjit mbi Ndërmarrje Publike dhe konsulenca është duke punuar në këtë raport, i cili do të paraqitet pranë NJPMNP-së, ku pas shqyrtimit finalizohet dhe do të publikohet në ueb faqe.

Roli dhe Përbërja e Bordit dhe Nënkomiteteve

Ka qenë një paqartësi e përgjithshme lidhur me përbërjen dhe rolin e bordit të drejtorëve. Ka pasur raste kur janë parashtruar pyetje lidhur me statusin e Zyrtarit Kryesor Ekzekutiv-së, për shembull: (a) a është ZKE-ja drejtor me të drejtë vote; dhe (b) a duhet që i punësuar i tanishëm të shërbejë menjëherë në bord apo duhet që ai/ajo të kalojë përmes procesit të rekrutimit (p.sh. kërkesa për ri-caktim).

Në pajtim me Ligjin e Ndërmarrjeve Publike, në secilën NP nga ana e Aksionarit është emëruar nga një Komision i Auditimit.

Për të adresuar këto paqartësi, NJPMNP ka hartuar Udhëzuesin për Drejtor të Ndërmarrjeve Publike (drejtor jo-ekzekutiv) dhe Modelin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.



Ligji i Ndërmarrjeve Publike

Dinamika kohore nga miratimi i Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe problemet praktike në implementimin e tij, kanë shtyrë NJPMNP-në në bashkëpunim me akteret të tjerë të fillojë ndryshimin e ligjit i cili është në strategjinë legjislative për vitin 2011 Finalizimi i tij ka përfunduar nga grupi punues qeveritar, dhe se shpejti pritet miratimi i tij në Kuvend.

Pavarësia e Punës së Bordit të Drejtorëve

Aksionari i NP-ve ka ushtruar mbikëqyrje të vazhdueshme të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve, mirëpo detyrimi për mbikëqyrje nuk do të ushtrohet në një mënyrë që ndërhyrje ose ka qëllim të ndërhyjë në veprimtarinë ose pavarësinë e bordit të drejtorëve, pavarësi kjo e rregulluar me Nenin 7.6 të LNP. NP-të kanë bazë komerciale dhe përveç që kryejnë funksionin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët, si qëllim përfundimtar ato duhet ta kenë maksimizimin e fitimit dhe çdo ngulfatje e veprimtarisë së bordit dhe menaxhmentit ka ndikim të drejtpërdrejtë në mosarritjen e këtyre qëllimeve.

Veprimet Korrektuese

Njësia e NP-ve është në dijeni që nevojiten përmirësime në monitorimin e nivelit të ndërmarrjeve. Dhe, njësia e NP-ve gjatë vitit 2010 ka bërë monitorimin e punës së bordëve duke analizuar proces verbalet e bordeve të drejtorëve, si dhe duke marrë pjesë në takimet e bordeve në cilësinë e vëzhguesit. Po gjatë vitit 2010 në të gjitha NP-të Qëndrore janë mbajtur 181 mbledhje të bordeve të drejtorëve dhe 158 mbledhje të Komisioneve të Auditimit. Nga Njësia e NP-ve dhe Ndërmarrja është kërkuar që të fokusohen në: (a) duke u siguruar që informatat e përgjithshme të jenë të gatshme me kohë; dhe (b) duke i krahasuar rezultatet aktuale me buxhetin dhe duke bërë analizat e duhura të ndryshimeve nga buxheti.

Gjatë vitit 2010 Njësia e NP-ve ka arritur progres drejt adresimit të çështjeve qeverisëse:

- (a) Duke realizuar kërkesat e bordit të drejtorëve mbi dhënien e këshillave nga stafi i NJPMNP-së;
- (b) Duke përgatitur, shpërndarë *Modeli –Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative të NP-së (Modeli i Kodit të NP-së dhe ModelStatutin e NP)*;
- (c) Duke përgatitur një formë të vlerësimit për t'u përdorur nga bordi dhe Njësia e NP-ve për ta drejtuar vlerësimin e performancës për secilin bord të NP-ve;
- (d) Duke i identifikuar dhe zhvilluar kurset për trajnimin e bordeve të NP-së dhe ekipin e menaxhmentit të lartë lidhur me:
 - (i) Leximin dhe interpretimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të auditimit;
 - (ii) Veprimet e bordit të drejtorëve (duke përdorur si bazë Udhëzuesin për Drejtor)
 - (iii) Kodi i Etikës dhe Qeverisja Korporative;



Inkasimi i të Hyrave për Shërbimet Komunale

Vështirësia e inkasimit të shumave nga konsumatorët është një problem i përhapur tek shërbimet komunale në secilën ndërmarrje publike në Kosovë (energji, ujë, dhe mbeturina), siç tregohet në Tabelën 7.

Tabela 7 Shkalla e Inkasimit për Shërbime Publike

	2009	2010	prog/reg
KEK më 2010	80%	88%	Trend pozitiv
Sektori I Ujërave	63%	66%	Trend pozitiv
Sektori i mbeturinave	55%	61%	Trend pozitiv

Sa i përket sektorit, për momentin, kostoja e inkasimit të borxhit paraqet vështirësi. Kosovës i mungon një gjyq për ankesa të vogla që do t'u mundësonte kreditorëve të gjurmojnë borxhet e vogla në mënyrë të shpejtë dhe efikase.

Andaj, ekziston një nevojë urgjente: (a) për t'i edukuar qytetarët se është obligim i tyre për t'i paguar shërbimet komunale të cilat ata i harxhojnë; dhe (b) për të themeluar një dhomë të veçantë të gjyqit e cila në mënyrë të shpejtë dhe efikase merret me zbatimin e pagesave për borxhet e papaguara të shërbimeve komunale. Mirëpo nevoja urgjente për investime në shërbimet komunale tregojnë që tani duhet presion për veprim në mënyrë që të shmangen përkeqësimet në nivelet e shërbimeve.

NJPMNP rekomandon që në fund të secilit vit një NP duhet të bëjë analizat e borxhlinjëve të vjetër dhe të llogaritë provizionin në bazë të atyre analizave. Nëse sistemi i faturimit nuk ofron këtë informatë, atëherë kompania duhet të ndërmarrë hapa që të avancojë sistemin e faturimit.



PJESA E TRETË – Performanca dhe Perspektiva e NP-ve



Sektori i Komunikimeve

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës

<i>Numri i regjistrimit</i>	70280741
<i>Emri i regjistrimit</i>	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a. (PTK)
<i>Data e inkorporimit</i>	23.01.2007
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Dardania, Prishtinë, Kosovë
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	€5,000,000.00
<i>Drejtoret</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Rexhë Gjonbalaj Qamil Buzhala Nuhi Ahmeti Shyqyri Haxha Elmaze Pireva Sahit Surdulli Gani Sylaj
<i>Kryesuesi</i>	Rexhë Gjonbalaj
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Shyqyri Haxha
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Nuredin Krasniqi
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Sebahedin Ramaxhiku
<i>Takimet e bordit</i>	Gjashtëmbëdhjetë(16) takime
<i>Formimi i Komiteteve të Bordit</i>	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	Emëruar më 6 Mars 2009 Nuhi Ahmeti – kryesues Qamil Buzhala Gani Sylaj
<i>Takimet</i>	
<i>Komitetet tjera</i>	Komiteti për Resurse Njerëzore Komiteti për Investime Kapitale Komiteti për Shërbime të reja të Marketingut dhe Konsumatorëve
<i>Auditori(ët) i jashtëm</i>	Grant Thornton LLC
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	BQK, PCB, RBKO, NLB, TEB, BpE, BE



Hyrje e Përgjithshme për Funkzionimin e PTK-së në vitin 2010

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) sh.a kryen ofrimin e shërbimeve të telekomunikimit, të telefonisë mobile dhe fikse, shërbimeve postare dhe shërbimeve të internetit.

PTK-ja ka tre funksione kryesore të afarizmit:

- (1) Shërbimet e telefonisë mobile VALA;
- (2) Telekomuni i Kosovës, i cili ofron shërbimet e linjës fikse; dhe
- (3) Posta e Kosovës.

Performanca Teknike

Shërbimet e Telefonisë Mobile VALA

Sipas Raportit Vjetor 2010 publikuar nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART) shërbimi i telefonisë mobile në Kosovë mbulon rreth 99% të popullsisë dhe 88% të territorit të Kosovës. Vala mbulon mbi 67% të tregut Kosovar me telefoni mobile gjegjësisht në vitin 2010 ka pasur 1.074.368 konsumator apo 23,368 konsumator më shumë së në vitin 2009.

Shërbimit të internetit/”broadband” nga raportet rezulton se mbulon rreth 34% të tregut me rreth 36,000 abonentë interneti.

Telekomi i Kosovës

Në Dhjetor të vitit 2010, PTK ka mbuluar me shërbimet e telefonisë fikse 93% të tregut apo ka pasur 83,000 abonentë.

Posta e Kosovës

Tabela 8 Shërbimet e Postës së Kosovës

Shërbimet	2010	2009
Lokale- Pakot	1,242	1,042
Pakot ndërkombëtare hyrëse-dalëse	12,480	10,880
M Bags hyrëse - dalëse	144	106

Me sa vihet re nga të dhënat e tabelës së mësipërme, numri i *pakove të brendshme* ka pësuar rritje nga 1,042 gjatë 2009 në 1,242 gjatë 2010, po kështu edhe *numri i pakove ndërkombëtare* hyrëse dhe dalëse nga 10,880 në 2009 në 12,480 gjatë 2010, që shënon rritje; si edhe “*M Bags*” hyrëse e dalëse kanë pësuar rritje gjatë 2010 me 144 në krahasim me 106 në 2009.



Performanca Financiare

PTK gjatë vitit afarist 2010 e përmbylli vitin me një fitim financiar vjetor prej 33,396,000.00 Euro.

Tabela 9 Rezultatet Financiare të PTK-së

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të ardhurat	151,503	145,030
Të ardhurat Tjera	482	50
Shpenzimet Operacionale	-26,047	-25,164
Shpenzimet e Stafit	-47,271	-40,583
Zhvlerësimi	-17,547	-16,155
Amortizimi	-7,146	-6,579
Humbja nga dëmtimi i bilanceve bankare	10	1,249
Shpenzimet tjera	-18,382	-19,737
Të hyrat e interesit	2,054	11,454
Fitimi përpara tatimit	37,656	49,565
Shpenzimi i tatimit në fitim	-4,260	-5,188
Fitimi neto për vitin	33,396	44,377
Të ardhura të tjera të përgjithshme për vitin		
Totali i të ardhurave të përgjithshme për vitin	33,396	44,377

Nga tabela e mësipërme paraqitet rritje e të ardhurave gjatë vitit 2010 në krahasim me vitin 2009. Në këtë tabelë vërehet se totali i të ardhurave të përgjithshme për vitin 2010 është më i vogël se ai për vitin 2009. Ndër faktorët kyq të profitit më të ulët së në vitin 2009 është zvogëlimi i të hyrave nga interesi bankar nga 11.4 të vitit 2009 në 2 Milion në vitin 2010, si rrjedhojë e pagesës së dividendes për aksionarin e cila drejtpërdrejt ka ndikuar në zvogëlimin e mjeteve të kursyera në bankë. Gjithashtu, të ardhurat do të ishin më të larta, por kjo ka qenë pamundur duke pasur parasysh zbritja e çmimeve nga shërbimet të ofruara nga Vala.

Në vazhdim shpenzimet e stafit pasqyrojnë një rritje në krahasim me vitin e kaluar. Kjo rritje është ndikuar si rezultat i kërkesave dhe nevojave për zgjerimin e gamës së shërbimeve dhe rritit të shpërndarjes dhe shtrirjes së PTK-së në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, e cila është e paraparë me planin e biznesit të njëjësive përkatëse në PTK.



Struktura e të Punësuarve

Tabela 10 Struktura e të Punësuarve në PTK

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	2558	2436
Nr. i punëtoreve (F)	799	769
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	693	673
Nr i punëtoreve me përgatitje të lartë shkollore	108	96
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	2367	2249
Nr i punëtoreve me përgatitje të ulët shkollore	189	187
Gjithsejtë	3357	3205

Nga tabela e mësipërme shihet një rritje e stafit në raport me vitin 2009 e cila ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së gamës shërbimeve dhe rritjes së numrin të konsumatorëve prej afër 24,000 klientëve e që kanë qenë të parapara edhe në planin e biznesit të korporatës. Duke parasysh vendimet mbi fillimin e procesit të privatizimit të PTK-së, Qeveria e Kosovës me një vendim ka kërkuar ngrirjen punësimit të mëtejme nga mesi i vitit 2010.

Raportimet Ligjore

Ligji mbi Ndërmarrje Publike përveq tjerave e parashih edhe raportimin të cilin ndërmarrja është e obliguar të kryej ndaj aksionarit. Më poshtë janë të përshkruara disa nga raportimet bazë të ndërmarrjes për aktivitetin e tyre biznesor.

Raportimet tremujore janë aprovuar rregullisht në mbledhjet e bordit të drejtorëve dhe japin shpjegim të aktiviteteve të ndërmarrjes në fushën operacionale, aktivitetet investuese, arritjet e të gjitha departamenteve, njësisë të biznesit dhe ndryshimet/zhvillimet në strukturën organizative, promovimet e stafit në grada më të larta, të dhëna operacionale, transaksionet e rëndësishme, pasqyra financiare tremujore krahasuar me vitin 2009, si dhe aktivitetin e zyrës ligjore dhe rastet e padive në gjykatë.

Raportimet vjetore janë miratuar nga bordii drejtorëve në përputhje me nenin 31 të LNP, jep një përmbledhje të arritjeve operacionale të ndërmarrjes për secilen njësi veçmas si dhe pasqyron shqetësimet të drejtuesve të shoqërisë sic është fenomeni e piraterisë SIM to SIM apo shqetësime relevante. Për këto shqetësime, PTK ka ndërmarrë masa për luftimin e kësaj dukurie duke i paraqitur tek organet përgjegjëse mbi luftimin e këtyre dukurive.

Plani Biznesit është i mirestrukturuar paraqet objektiva të qarta, dhe është një dokument përmbledhës i përbërë nga tri njësitë e biznesit me argumentimet përkatëse.

Pasqyrat Financiare janë miratuar në mbledhjet e bordit të drejtorëve. Raporti i auditorit të jashtëm për Pasqyrat Financiare të vitit 2010, të aprovuara nga Zyrtari Kryesor Ekzekutiv, Zyrtari Kryesor Financiar dhe Kryesuesi i bordit të drejtorëve, jep opinion të pakualifikuar (pozitiv) për saktësinë e tyre në paraqitjen e gjendjes operacionale dhe financiare të shoqërisë.



Sektori i Transportit

Hekurudhat e Kosovës

<i>Numri i regjistrimit</i>	70325327
<i>Emri i regjistrimit</i>	Hekurudhat e Kosovës Sh.a. (HK)
<i>Data e inkomporimit</i>	22 Dhjetor 2005
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Fushë Kosovë-sheshi i Lirisë.
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€(i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Sejdi Hoxha Hysen Fazliu Halil Kikaj Fadil Krasniqi Halim Peci Agron Thaqi
<i>Kryesuesi</i>	Sejdi Hoxha
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Xhevat Ramosaj (UD)
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Sefedin Sefaj (UD)
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Ruzhdi Morina
<i>Takimet e bordit</i>	11 takime gjatë vitit 2010
Formimi i Komiteteve të Bordit	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet</i>	11 takime gjatë vitit 2010
<i>Komitetet tjera</i>	Komiteti për Burime Njerëzore Komiteti për Investime Kapitale Komiteti për Siguri
<i>Auditor(ët) i jashtëm</i>	Grant Thornton, BORDI I DREJTORËVEO
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	NLB, PCB, Raiffeisen Bank



Hyrje e Përgjithshme në Funkcionimin e Hekurudhave të Kosovës

Hekurudhat e Kosovës si e vetmja ndërmarrje e licensuar për ofrimin e shërbimeve të komunikacionit hekurudhor për transport të qytetareve dhe të mallrave ka 333,451 km të linjave hekurudhore të hapura, 105,784 km të linjave stacionare dhe 03 km të linjave industriale. Rrjeti i saj ka 23 tunele, me gjatësi totale prej 9,020 metra dhe 155 ura me gjatësi totale prej 2,9 km. Megjithatë, infrastruktura është e vjetër dhe ka nevojë për investime rinovuese. Në vitin 1999 sistemi hekurudhor, në vijim të viteve të investimeve të ulëta dhe periudhës së luftës, pothuajse kishte pushuar funksionimin.

Mbështetur në Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës, Qeveria mori Vendim mbi ndarjen e Hekurudhës së Kosovës në Operime, apo TRAINKOS dhe Infrastrukturë apo INFRAKOS dhe tanimë këto dy kompani janë regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa është në finalizim shturja financiare e këtyre ndërmarrjeve.

Me përkrahjen e donatorëve të ndryshëm dhe Qeverisë, HK-ja ka arritur ta riparojë shumicën e infrastrukturës së saj dhe të gjitha linjat janë operative përveç dy linjave, Xërxë- Prizren (27km) dhe Prishtinë – Podujevë (37km). Sot HK operon me 6 shërbime ditore për udhëtarë:

- Liria e Lëvizjes së Trenit (Fushë Kosovë - Shkup dhe anasjelltas, edhe pse deri në Mars të vitit 2008 kjo ka vepruar deri në Leshak). Ky shërbim dy herë në ditë është plotësisht i subvencionuar nga Ministria e Infrastrukturës.
- Prishtinë- Pejë- Prishtinë dy herë në ditë; dhe

Shërbimet e lëvruara nga HK janë si më poshtë:

- Transporti konvencional i mallrave
- Transporti me kontejnerë
- Transporti i udhëtarëve
- Mirëmbajtja e vagonëve

Ne këtë kuadër është përgatitur edhe Strategjia Qeveritare për Modelin e Transportit e aprovuar në Nëntor të vitit 2009, e cila tregon të ardhmen e HK-së deri në vitin 2030. Kjo përfshin planin për ndarjen e infrastrukturës hekurudhore, e cila tanimë është në realizim e sipër dhe pritet t'i inkurajojë operatorët privatë.

Investimet kapitale intensive do të kërkohen për t'u realizuar ky plan, pasi vlerësohet se rreth 252 km të rrjetit hekurudhor të tanishme (Linja 10) kanë nevojë për investim.



Performanca Operative

Tabela 11 Performanca Operative

	2010	2009
Nr. i Udhëtareve	376,770	374,504
Transporti i mallrave në 000 Ton	1,128,658	911,830

Të dhënat e tabelës së mësipërme tregojnë një trend të rritjes së indikatorëve operativë posaqerisht ato mbi transportin e mallrave që kanë trende të rritjes prej 20% në krahasim me vitin paraprak.

Performanca Financiare

Tabela 12 Performanca Operacionale dhe Financiare në HK

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të hyrat nga operacionet	5,532	5,382
Të hyrat nga grandet	2,360	688
Kosto e shërbimeve të bëra	-6,798	-5,862
Bruto fitimi	1,094	208
Provizioni për borxhet e dyshimta	-497	0
Shpenzimet tjera operative	-694	-595
Humbja nga operacionet	-97	-387
Të ardhurat financiare	36	32
Humbja para tatimit	-65	-355
Tatimi në të ardhura	0	0
Humbja neto për vite	-65	-355

Hekurudhat e Kosovës mund të vlerësohen që kanë arritur treguesit pozitiv financiar duke rritur të hyrat dhe duke zvogëluar humbjet operative për 75% në krahasim me vitin 2009 si dhe ka zvogëluar humbjet neto financiare të ndërmarrjes për 82% në krahasim me vitin 2009.



Struktura e Stafit

Tabela 13 Struktura e Stafit në HK

Hekurudhat e Kosovës	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	451	384
Nr. i punëtoreve (F)	17	16
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	45	36
Nr i punëtoreve me përgatitje të lartë shkollore	20	19
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	309	253
Nr i punëtoreve me përgatitje të ulët shkollore	94	92
Gjithsejtë	468	400

Nga tabela e mësipërme shihet se nga numri i tërësishëm i të punësuarve dominon ajo nga gjinia mashkullore me 96% ndërsa nga përgaditja profesionale zënë vend me 14% ajo me përgaditje të lartë dhe superior por dominon përgaditja e mesme shkollore me 66%.

Raportimet Ligjore

Ligji mbi Ndermarrje Publike përveq tjerave e parasheh edhe raportimin të cilin ndermarrja është e obliguar ta kryej ndaj aksionarit. Më poshtë janë të përshkruara disa nga raportimet bazë të ndermarrjes për aktivitetin e tyre biznesor.

Raportimet tremujore të aprovuara nga Bordi i Drejtoreve japin një paraqitje të detajuar të aktiviteteve dhe treguesve operacionalë e financiarë duke i analizuar dhe argumentuar ndryshimet me të njëjtën periudhë 2009 dhe buxhetin e vitit 2010. Prezantohet saktësi, plotësi e transparencë të dhënash nga gjithë veprimtaria e NP, fakt që tregon një menaxhim të mirë të rrjedhës së informacionit nga poshtë lart dhe ndër departamentesh. Vlerësohet, gjithashtu si pozitive ruajtja e të njëjtit standard në raportim, ka konsistencë procedure e menaxhimi të cilësisë së informacionit dhe raportimit.

Raporti Vjetor është profesional dhe paraqet punën njëvjeçare dhe aktivitetet e Bordit të Drejtorëve, ekzekutivit, aktivitetet e Divizionit të Infrastrukturës, transportit të trenave, si dhe departamentet mbështetëse: financat, prokurimet, burimet njerëzore, së bashku me objektivat për vitin 2010.

Plani i Biznesit është përgatitur shumë cilësisht me analizë shërbimesh, strukture organizative dhe përshkrim të burimeve njerëzore, analizën SWOT, pasqyrën e të ardhurave dhe rezultatin financiar, objektivat në rritje, strategjinë e rritjes, burimet përkatëse, organizimin dhe kontrollin e brendshëm, detyrimin ndaj konsumatorit, dhe çeshtje tjera biznesore. Jepet krahasimi i treguesve operacional dhe financiar me vitin 2009, projektet kapitale të vitit 2009 mbartur në vitin 2010, si dhe projektet e reja të nisura në 2010. Analizë e detajuar e të ardhurave e shpenzimeve. Bordi i drejtorëve ka shprehur angazhim në ngritjen e mjedisit të kontrollit në shoqëri, me gjithë mangësitë e pranishme për të cilat është i ndërgjegjshëm dhe është në përpjekje të vazhdueshme.



Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”

<i>Numri i regjistrimit</i>	70280980
<i>Emri i regjistrimit</i>	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës Sh.a (ANP)
<i>Data e inkuorporimit</i>	22 Qershor 2005
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Vrellë-Lypjan (Sllatinë)
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€ (i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i>
	Bekim Jashari
	Naser Canolli
	Besnik Krasniqi
	Fejzulla Krasniqi
	Hanefi Muharremi
	Bislim Zogaj
<i>Kryesuesi</i>	Bekim Jashari
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Agron Mustafa
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Bahri Nuredini
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Shqipe Deveja-Fazliu
<i>Takimet e bordit</i>	13 takime gjatë vitit 2010
Formimi i Komiteteve të Bordit	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet</i>	11 takime gjatë vitit 2010
<i>Komitetet tjera</i>	Komiteti për Burime Njerëzore
	Komiteti për Investime Kapitale
	Komiteti për Ndarje të Navigimit
<i>Auditor(ët) i jashtëm</i>	Grant Thornton
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	RFB, NLB, PCB, TEB, BPB, dhe BE



Hyrje e Përgjithshme në Funksionimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP), është një ndërmarrje publike, veprimtaria e së cilës bazohet në qarkullimin civil dhe në qarkullimin ushtarak. ANP mundëson fluturimet prej Kosovës në shumë vende të botës dhe anasjelltas për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe shteteve tjera.

ANP po ashtu mundëson edhe shërbime të tjera sic janë:

- salla për klasën e biznesit, e cila është për pasagjerët e kësaj klase
- duty free shop i cili është i liruar nga taksat doganore,
- bankat dhe zyrat postare,
- kargo - ofrimin e bartjes së mallrave,
- mundësi reklamimi,
- restorantet,
- parkingu,
- si dhe dyqane të ndryshme.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës është aset strategjik publik me rëndësi shumë të madhe për qytetarët e Kosovës dhe për zhvillimin e shtetit. Për këtë arsye Qeveria i ka ofruar partneritetit privat një mundësi për të investuar në këtë aset duke krijuar një ambient të mirë, infrastrukturë dhe shërbime të nivelit të lartë në pajtim me normat ndërkombëtare.

Viti 2010 për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” mund të konsiderohet si vit i transferit nga ndërmarrje publike në Partneritetin Publiko-Privat. Kjo pasiqë, me 12 Gusht 2010, është nënshkruar kontrata e partneritetit publiko-privat mes Qeverisë së Kosovës dhe konzorciumi turko – francez Limak - Aeroports de Lyon. Mirëpo, transferi i aseteve, i përgjegjësi dhe i kompetencave të ANP-së ka kaluar në operim të partnerit privat në Prill të vitit 2011. Vlenë të theksohet se jashtë kontratës së koncesionimit ka mbetur pjesa e kullës dhe kontrollit ajror e cila është në pronësi të Qeverisë dhe funksionon normalisht si ndërmarrje publike.

Performanca Operacionale

Tabela 14 Performanca Operacionale në ANP

	2010	2009
Nr. i pasagjerëve	1,307,906	1,232,778
Nr. i aterimeve	6,548	5,975

ANP ka arritur të mira në treguesit e saj operacionale të vitit 2010, sidomos në tejkalim të treguesve të numrit të udhëtarëve prej 6% më shumë se në vitin paraprak dhe rritjes së numrit të aterimeve të aeroplanëve për 9% më shumë se në vitin 2009.



Performanca Financiare

Tabela 15 Performanca Financiare në ANP

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të hyrat nga operimet		
Të ardhura nga shitjet	24,221	22,402
Të ardhura tjera nga operimet	3,453	6,158
	27,674	28,560
Kostot e operimit		
Kostot financiare	-21,263	-17,275
Përfitimi nga operimet	6,411	11,285
Të ardhura financiare		
Të ardhura financiare	390	429
Kostot financiare	-13	-351
Rezultati financiar, neto	377	78
Përfitimi para taksës në të ardhura	6,788	11,363
Shpenzimi nga taksa në të ardhura	-610	-1,130
Fitimi neto për vitin	6,178	10,233
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse		
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	6,178	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	6,178	10,233
Profiti neto që i atribuohet mbajtësve të aksioneve të zakonshme	6,178	10,233
Fitimi financiar	6,178	10,233

Nga tabela e mësipërme vërehet se kompania ka fitim financiar prej 6.1 milion Euro, që në fakt është një fitim më i vogël se në vitin paraprak. Ky zvogëlim është si rrjedhojë e rritjes së shpenzimeve nga investimet kapitale dhe shpenzimeve të operimit, si dhe zvogëlim i të hyrave nga interesi bankar pasi që ANP ka deklaruar dhe paguar dividend në vlerë prej 10 milion Euro ndaj aksionarit.



Struktura e Stafit

Tabela 16 Struktura e Stafit në ANP "Adem Jashari"

ANP "Adem Jashari"	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	683	659
Nr. i punëtoreve (F)	138	135
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	87	80
Nr i punëtoreve me përgatitje të lartë shkollore	11	10
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	704	685
Nr i punëtoreve me përgatitje të ulët shkollore	19	19
Gjithsejtë	821	794

Nga tabela e mësipërme vërehet se të punësuarit kanë strukture dominuese të gjinisë mashkullore prej 683 të punësuarve, dhe strukture dominuese të përgatitjes së mesme shkollore prej 704.

Raportimet Ligjore

Raportet tremujore janë të mirëstrukturuar dhe japin informacion të bollshëm dhe analiza të mjaftueshme të treguesve të aktivitetit, përkundrejt periudhave pararendëse dhe planit të biznesit. Ato janë aprovuar në kohë nga bordi i drejtorëve dhe paraqitur në NJPMNP në MZHE.

Raporti Vjetor paraqet rezultatet operacionale dhe financiare të ANP-së. Bordi i Drejtorëve dhe zyrtarët e lartë kanë qenë të angazhuar në menaxhimin operacional të aktivitetit gjatë vitit 2010. Detyrë e menjëhershme e Bordit të Drejtorëve ishte konsolidimi i pjesës së mbetur të ANP "Adem Jashari", si pjesë e pakoncesionuar, si dhe qartësimi i funksionit dhe autoritetit të ekzekutivit. Në të njëjtën kohë njihet angazhimi profesional i Bordit të Drejtorëve dhe përpjekjet e tij për ta respektuar kuadrin ligjor në përgjithësi,

Plani i Biznesit është punuar dhe miratuar para 31 tetorit dhe mes të tjerash shpreh shqetësim për mungesë kapaciteti në ndërtesën e terminalit të udhëtarëve, sidomos në kohë piku, nevojën për investim, automatizimin e parkingut komercial, si edhe një argumentim të mirë të të ardhurave dhe shpenzimeve të pritshme për vitin 2010. Aty prezantohet dhe zbatimi i Planit Nxitës, i cili konsiston në ofrimin e ofertave promovuese të linjave ajrore që do të lidhin marrëveshje të reja bashkëpunimi me ANP, ndërsa këto linja do të përfitonin zbritje të ndjeshme në 3-vjeçarim e parë të marrëveshjes.



Sektori i Energjisë

Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu (KOSTT)

<i>Numri i regjistrimit</i>	70325350
<i>Emri i regjistrimit</i>	Operatori i Sistemit të Bartjes dhe Tregut Sh.a (KOSTT)
<i>Data e inkorporimit</i>	22.12.2005
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Bill Clinton - Prishtinë
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€ (i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Ramadan Pacarda Faton Deda Lutfi Maxhuni Nazim Mikullovc Ramadan Pacarda Fadil Rrustemi
<i>Kryesuesi</i>	Ramadan Pacarda (UD)
<i>Kryeshëfi Ekzekutiv</i>	Fadil Ismajli
<i>Zyrtari Kryesor</i>	Nebih Haziri
<i>Financiar</i>	
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Merita Kostari
<i>Takimet e bordit</i>	11 takime gjatë vitit 2010
Formimi i Komiteteve të Bordit	Komisioni për Projekte Kapitale Komisioni për Ndarje Mjetesh KEK-KOSTT Komisioni për linjën 400kV Kosovë - Shqipëri
<i>Komisioni i Auditimit</i>	9 takime në 2010
<i>Takimet</i>	
<i>Auditor(ët) i jashtëm</i>	KPMG
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	RFB



Hyrje e Përgjithshme në Funkcionimin e KOSTT-it

Si Operator i Sistemit të Transmisionit (OST), KOSTT-i është e licencuar dhe ka përgjegjësi për:

- Planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë;
- Sigurimin e një qasjeje të hapur dhe jodiskriminuese;
- Funksionimin e tregut të ri të energjisë elektrike;
- Sigurimin e kushteve, të cilat nxisin konkurrencën në Kosovë;
- Bashkëpunimin me OST-të (Operatorët e Sistemit të Transmisionit) fqinjë në dobi të Kosovës dhe të rajonit.

KOSTT-i ka një pozicion strategjik dhe përfaqëson një nyje të rëndësishme në tregun rajonal ndërkombëtarë të energjisë elektrike. KOSTT ndërlidhet me katër sisteme të tjera, atë të Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi.

Struktura organizative e KOSTT-it është përcaktuar të ketë një afarizëm të pavarur dhe përbëhet nga afarizmi themelor tekniko operativ: Operatori i Sistemit, Operatori i Transmisionit, Operatori i Tregut.

KOSTT-i duhet të përgatitet për efektet e gjenerimit të ri, nga aspekti i kyçjeve dhe përforcimit të rrjetit. Ndërtimi i Kosovës së Re do ta shndërrojë Kosovën në një eksportues të energjisë elektrike. Energjia elektrike kryesisht furnizohet nga termocentrali me linjit 'Kosova A' dhe 'Kosova B', ku 'Kosova B' furnizon gati 75% të prodhimit vendor. Ngarkesa e pikut aktualisht është rreth 1000 MW. Kapaciteti i tërësishëm i gjenerimit do të ishte rreth 930 MW nëse do të ishin në dispozicion të gjitha njësitë.

Aktualisht KOSTT, nuk është subjekt i presioneve direkte konkurruese për t'i ulur kostot, por është nën presionin e rregullatorit dhe kërkesës për investime të reja të rrjetit të transmisionit për Shqipëri dhe Maqedoni. Prandaj, KOSTT-i është në përpjekje për ta ngritur efikasitetin e operimeve të tij.

Performanca Operacionale

Tabela 17 Performanca Operacionale në KOSTT

	2010	2009
Ndërprerjet në transmision	230	771
Humbjet në transmision	131.04 GWh	174,57GWh

KOSTT ka realizuar një vit të mbarë operacional gjatë 2010 falë rritjes së shërbimit të transmetimit të energjisë dhe rënies së dukshme të ndërprerjeve.

Nga tabela e mësipërme vërehen trende pozitive të treguesve operativ në zvogëlimin e humbjeve në transmision nga 174.5 mij GWh në 2009 në 131 mij GWh në vitin 2010 si dhe zvogëlim të ndërprerjeve në transmision nga 771 në 2009 në 230 në vitin 2010.



Performanca Financiare

Tabela 18 Përmbledhja e Performancës Financiare në KOSTT

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të ardhura		
Të ardhura nga shërbimet e transmetimit	20,076	20,061
Të ardhurat tjera	2,348	977
Të ardhurat totale	22,424	21,038
Shpenzimet Operative		
Shpenzimet e Stafit	-2,736	-2,338
Amortizimi dhe Zhvlerësimi	-4,866	-3,001
Riparime dhe Mirëmbajtje	-752	-918
Humbje në transmisionin e energjisë	-4,319	-5,212
Shpenzimet e tjera operative	-4,121	-1,258
Rregullim Dytësor	-1,600	-996
Shpenzime për Lënde Djegëse	-190	-79
Fitimi Operativ	-18,584	-13,802
Të ardhura interesi	301	219
Fitimi përpara tatimit	4,141	7,455
Tatimi mbi fitimin	-673	691
Fitimi neto i periudhës	3,468	6,764
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	3,468	6,764

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme vërehet se të ardhurave të përgjithshme kanë pësuar rritje për 7% nga viti paraprak. Por gjithashtu ka edhe rritje të shpenzimeve të zhvlerësimit dhe shpenzimeve tjera operative të cilat kanë ardhur si rrjedhojë e investimeve të reja kapitale në paisje dhe si rezultat i të gjitha lartpërmendura kemi edhe një rënie të fitimit neto financiar në vlerë afër 3 milion Euro.

Struktura e Stafit

Struktura aktuale organizative e KOSTT-it është e përshtatshme për zhvillimet e parashikuara në periudhën e planifikuar. Megjithatë, mund të nevojiten ndryshime në arsyetimin e përshtatjes së saj ndaj ndryshimeve në proceset e biznesit dhe për të përfituar nga mundësitë e rritura për ta përmirësuar efikasitetin. Struktura e të punësuarve në KOSTT është e paraqitur në tabelen e mëposhtme.



Tabela 19 Struktura e të Punësuarve në KOSTT

KOSTT	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	192	174
Nr. i punëtoreve (F)	47	44
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	111	98
Nr i punëtoreve me përgatitje të lartë shkollore	16	15
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	106	99
Nr i punëtoreve me përgatitje të ulët shkollore	6	6
Gjithsejtë	239	218

Nga tabela e mësipërme shihet së në strukturën superiore vërehet një tregues shumë i mirë i ndërtimit të kapaciteteve njerëzore profesionale nga afër 53% të stafit ka përgatitje të lartë dhe superiore profesionale, tregues që është i mirëseardhur për të gjitha NP-të tjera.

Raportimet Ligjore

Raportet tremujore janë të mirëstrukturuara dhe kanë një format standard që fillon me përshkrimin e strukturës organizative dhe ndryshimet në staf, përshkrimin e treguesve kryesorë operacional dhe financiar për të tri njësitë e biznesit, krahasuar me rezultatet e së njëjtës periudhë të vitit 2009, si edhe buxhetin përkatës të vitit 2010.

Raportet, gjithashtu përshkruajnë projektet kapitale dhe statusin e zbatimit të tyre, çështjet ligjore dhe rregullative me shpjegime e listime, pasqyrat përkatëse financiare, shoqëruar me analizë treguesish operacional dhe raportesh financiare, përshkrim të projekteve të rëndësishme arritjet, dështimet dhe sugjerimet për çdo Njesi Biznesi dhe departament; si edhe përshkrim të aktiviteteve më të rëndësishme të Kryeshefit Ekzekutiv, Bordit të Drejtoreve, dhe Komisioneve përkatëse.

Raporti Vjetor ruan të njëjtën strukturë dhe përmbajtje me raportet tremujore, fakt që jep vijueshmëri në leximin e performancës së shoqërisë. Treguesit e performancës janë paraqitur shumë të detajuar dhe mirë argumentuar, prezantimi i projekteve kapitale bëhet i ndarë për realizimet me fondet e Buxhetit të Qeverisë dhe fondet e KOSTT, dhe në fund jepet paraqitje e funksionimit të qeverisjes korporative në ndërmarrje.

Plani i Biznesit është aprovuar nga Bordi i Drejtoreve sipas afatit të caktuar në ligj. Është një plan serioz ku janë shtjelluar me përpikëri struktura organizative, dinamika e zhvillimit të tregut të energjisë në vend dhe kuadri ligjor e rregullator vendas dhe ai rajonal që mbulon aktivitetin e KOSTT, aspektet sociale dhe mjedisore, analiza SWOT, planet e investimit sipas prioriteteve strategjike, parashikimet e të ardhurve, dhe shpenzimeve me pasqyra financiare.



Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

<i>Numri i regjistrimit</i>	70325399
<i>Emri i regjistrimit</i>	Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a (KEK)
<i>Data e inkomporimit</i>	22.12.2005
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Nëna Terezë Nr. 36, Prishtinë
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€ (i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Fadil Çitaku Arben Gjukaj Izet Ibrahim Ismail Jonuzi Flamur Keça Agim Nika
<i>Kryesuesi</i>	Fadil Çitaku
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Arben Gjukaj
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Salih Bytyqi
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Nexhat Podrimaj
<i>Takimet e bordit</i>	13 takime gjatë vitit 2010
Formimi i Komiteteve të Bordit	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet</i>	
<i>Komitetet tjera</i>	Komiteti për Sibovcin Jugperëndimor
<i>Auditori(ët) i jashtëm</i>	Deloitte Kosova, sh.p.k.
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	PCB, RFB, BE, NLB, BPB, TEB, dhe BKT



Hyrje e Përgjithshme në Funkcionimin e KEK-ut

Sektori i energjisë është shumë i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. Përderisa furnizimi me energji është përmirësuar për shumicën e popullatës, kjo është bërë e mundur vetëm për shkak të rritjes së performancës së Korporatës Energjetike të Kosovës, si dhe përkrahjes nga Qeveria. Mirëpo, kapacitetet e kufizuara buxhetore nënkuptojnë përkrahje më të vogël për importim të energjisë në të ardhmën.

Duke pasur parasysh përmirësimin e performancës së KEK si dhe rritjes së kapaciteteve prodhuese të energjisë, Qeveria ka arritur të zvogëlojë subvencionet për importin e energjisë elektrike.

Megjithatë, ekziston një nevojë për investime të mëdha në sektorin e energjisë dhe kjo do të vijë nga sektori privat. Megjithatë, sektori karakterizohet nga tarifat e ulëta. Këto janë çështje shumë me rëndësi, të cilat bordi i KEK-ut dhe menaxhmenti duhet t'i adresojnë.

Performanca e Sektorit të Energjisë në përgjithësi ka trende pozitive, e cila shprehur në disa indikatorë fizik do të dukej kështu:

- Prodhimi i Qymyrit prej 7.96 mil tonë, apo më shumë se në vitin 2009 për 1.52%;
- Prodhimi i Energjisë prej 5.5 mil MWh, apo më shumë se në vitin 2009 për 4%;
- Inkasimi i Energjisë prej 177.8 mil, apo për 11% më shumë se në vitin 2009, ndërsa ky inkasim mbulon 87.9% të faturimit të përgjithshëm;
- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të energjisë janë ulur për 1.22% në krahasim me vitin 2009.

Performanca Operative e KEK

Tabela 20 Performanca Operative në KEK

	2009	2010
Prodhimi i thëngjillit (000s ton)	7,839	7,958
Prodhimi bruto (MWh 000s)	5,260	5,481
Prodhimi neto (MWh 000s)	4,676	4,863
Totali i Energjisë (MWh 000s)	5,242	5,465
Humbjet teknike	16.63%	17.05%
Humbjet komerciale	23.63	22.47%
Humbjet Totale	40.73%	39.51%

Gjatë vitit 2010 KEK ka pasur arritje në caqet e shumicës së treguesve operacionale, si në prodhimin bruto, neto dhe totalin e energjisë së prodhuar, zvogëlimin e humbjeve teknike në rrjet dhe të humbjeve në enklava. KEK ka shënuar rritje të treguesve të prodhimit të qymyrit në vitin 2010. Mbetet detyrë e vazhdueshme e KEK të intensifikojë përpjekjet për uljen e humbjeve në tërësi, dhe sidomos të atyre komerciale nëpërmjet rritjes së kontrolleve të lidhjeve të paligjshme dhe abuzimeve në rrjet dhe legjitimitit të të gjithë konsumatorëve që përfitojnë energji elektrike.



Indikatorët kryesor (Prodhimi i Energjisë Bruto/Neto) tregojnë një performancë të mirë të kësaj ndërmarrje në vitin 2010 me trend pozitiv. Gjatë këtij viti prodhimi i energjisë elektrike ka qenë 5,480,972 MW/h Bruto, ndërsa 4,862,174 MW/h Neto në termocentralet Kosova A dhe B. Në krahasim me vitin 2009, viti 2010 ka pasur një rritje të prodhimit të energjisë elektrike për 4%.




Figure 1 Prodhimi i Energjisë 2009 - 2010

Gjithashtu edhe divizioni i mihjeve në KEK ka pasur ngritje të nivelit të prodhimit. Në krahasim me tri vitet e kaluara, viti 2010 ka shënuar rritje të prodhimit të qymyrit nga 7,839,173 ton në 2009 në 7,958,090 ton në vitin 2010. Në krahasim me vitin 2009, divizioni i mihjeve në KEK ka pasur një rritje për 1,52%.




Figure 2 Prodhimi i Qymyrit 2009 - 2010

Në vazhden e ngritjeve të prodhimit të energjisë në KEK, edhe divizioni i rrjetit ka pasur gjithashtu ngritje të nivelit të inkasimit. Në vitin 2010, 97.3% është përqindja e leximit të njehsorëve, 98.8% ka qenë shkalla e shpërndarjes së faturave, ndërsa 80.0% ka qenë faturimi i energjisë së disponueshme për shitje ose 96.6% e planit të parapare për vitin 2010. Nga ky faturim, përqindja e inkasimit për vitin 2010 ka qenë 87.9 ose 108.2% si përqindje e realizimit nga plani i parapare i cili ka qenë 81.22%.




Figure 3 Faturimi dhe Inkasimi si % e Faturimit 2009 - 2010



Performanca Financiare në KEK

Tabela 21 Performanca Financiare në KEK

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të Hyrat Operative		
Shitjet	192,757	174,392
Të ardhurat nga grantet	44,055	58,268
Të ardhurat tjera	2,015	5,044
	238,827	237,704
Shpenzimet Operative		
Zhvierësimi dhe Amortizimi	-29,163	-23,624
Shpenzimet e Stafit	-51,434	-46,657
Energjia elektrike dhe shërbimet tjera publike	-77,736	-83,109
Shpenzimet e mirëmbajtjes	-6,505	-8,217
Materialet dhe furnizimet	-17,336	-10,938
Provizionet për shlyerjen e stoqeve	-1,911	
Humbja nga shlyerja e llogarive të arkëtueshme	-22,085	-25,625
Shpenzimet e provizioneve për mjedis dhe çështje tjera	-5,863	-21,068
Shpenzimet tjera operative	-12,832	-13,329
	-224,865	-232,567
Fitimi/(humbja) nga operacionet	13,962	5,137
Ngarkesat financiare, neto	186	-154
Fitimi/(humbja) para tatimit	14,148	4,983
Shpenzimet e tatimit në fitim		
Fitimi neto/(humbja) për vitin	14,148	4,983
Të hyra tjera gjithëpërfshirëse		
Gjithsej të hyrat (humbja) gjithëpërfshirëse	14,148	4,983

Për sa i përket treguesve financiar, KEK gjatë vitit 2009 dhe 2010 ka arritur një performancë pozitive, duke shënuar rritje prej 9,165 milion Euro krahasuar me vitin paraardhës dhe tejkalim me rreth 3% të caqeve të të ardhurave, ndërsa zvogëlim për 7,702 milion Euro të shpenzimeve operacionale.

Në treguesit e të hyrave të përgjithshme janë përfshirë edhe të hyrat nga grantet qeveritare për importin e energjisë elektrike të cilat sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit pranohen si të hyra dhe kjo është e pranuar edhe nga auditorët e jashtëm në raportin e tyre.



Struktura e Stafit

Tabela 22 Struktura e Stafit në KEK

KEK	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	7146	7210
Nr. i punëtoreve (F)	559	558
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	824	819
Nr i punëtoreve me përgatitje të lartë shkollore	483	479
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	4326	4419
Nr i punëtoreve me përgatitje të ulët shkollore	2072	2051
Gjithsejtë	7705	7768

Nga tabela e mësipërme shihet se struktura profesionale e të punësuarve arrinë 17% me përgatitje të lartë e superiore dhe 56% me përgatitje të mesme shkollore.

Raportimet Ligjore

Raportet tremujore paraqesin operacionet, aktivitetet investuese, projektet e pezulluara, arritjet e gjithë departamenteve, strukturën organizative, të dhëna operacionale, transaksionet e rëndësishme, pasqyrat financiare të periudhës krahasuar me 2009 dhe buxhetin, si dhe rastet e padive në Gjykatë. Këto raporte janë shqyrtuar dhe aprovuar në komisioni e auditimit dhe bordin e drejtoreve.

Raporti Vjetor paraqet në mënyrë narrative dhe me tabela performancën teknike dhe operacionale të divizioneve dhe departamenteve përkatëse ne Korporaten Energjetike te Kosoves.

Plani i Biznesit paraqet strukturën e njësive të biznesit në KEK, si edhe tregues operacionalë të prodhimit e shitjes në çdo njësi, masën e faturimit dhe arkëtimit, dhe njësive tjera si dhe paraqet planin e veprimit per vitet ne vijim.



Sektori i Ujërave

Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) ka licencuar shtatë ndërmarrje rajonale të ujësjellësit. Bazuar në numrin e konsumatorëve familjarë për shërbimet e ujit të faturuar nga këto kompani, është vlerësuar që ato furnizojnë ujë vetëm për 1.3 milion (72%) të popullatës në Kosovë prej 1.8 milion banorëve.

Në vitet e kaluara investimet kapitale në sektorët e ujit është bërë e mundur nga përkrahja e Qeverisë, donatorët, dhe mjetet vetanake të ndërmarrjeve. Gjatë vitit 2010, Qeveria ka ofruar grante kapitale në total prej 1.7 milion Euro, mjete vetanake afër 1 mil, dhe të tjerat nga donatorët. Këto shuma janë të ulëta në krahasim me kërkesat për investime kapitale në këta sektorë; dhe do të jetë një sfidë e madhe për të gjetur burimet e nevojshme financiare.

Me qëllim të rritjes së nivelit të shërbimeve për qytetarët e Kosovës, donatorët kanë shprehur vullnetin që të investojnë në Ujësjellësit e Kosovës si: Komisioni Evropian, në Regjionin e Mitrovicës dhe në fabrikën e ujit në Prishtinë; USAID në Prishtinë, Prizren e Pejë, SDC (Qeveria Zvicerane) të financojë në regjionin e Gjilanit dhe Ferizajt, e sidomos në zonat rurale, qeveria e Luksemburgut në rrjetin e Mitrovicës, si dhe regjione tjera nga donatorë të ndryshëm.

Tabela 23 Treguesit Operativ në Sektorin e Ujërave

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pafaturuar(humbja e ujit) %	60%	58%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	80%	79%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	66%	63%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	1.05	0.97	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m ³)	0.09	0.11	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.64	6.7	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	55.2	41.5	Trend negativ



Inkasimi në Ndërmarrjet e Ujërave në Kosovë

Tabela 24 Inkasimi në Ndërmarrjet e Ujërave në Kosovë

Viti	Kompania rajonal e ujit	Uji i pafaturuar %	Shkalla e arkëtimit %	Efikasiteti i stafit ('000 kons)
2009	KRU Prishtina	54%	65%	5.75
	KRU Hidroregjioni Jugor	55%	60%	6.05
	KRU Hidrodrini	74%	60%	5.7
	KRU Mitrovica	51%	51%	10.27
	KRU Radoniqi	55%	69%	8.01
	KRU Hidromorava	57%	63%	8.9
	KRU Bifurkacioni	57%	61%	6.59
2010	KRU Prishtina	55%	70%	5.65
	KRU Hidroregjioni Jugor	58%	69%	6.38
	KRU Hidrodrini	72%	59%	5.51
	KRU Mitrovica	53%	55%	10.26
	KRU Radoniqi	65%	67%	7.9
	KRU Hidromorava	60%	68%	8.3
	KRU Bifurkacioni	60%	61%	6.19

Në shkallën e ulët të inkasimit kontribuojnë katër faktorë:

1. Sistemi i inkasimit është jomjaftueshëm-efikas.
2. Konsumatorët nuk janë të kënaqur me nivelin e shërbimeve dhe refuzojnë të paguajnë.
3. Konsumatorët e dinë se edhe nëse nuk paguajnë nuk do të ndodh asgjë, pasi edhe nëse paditen në gjykatë lënda e tyre nuk kryhet.
4. Faktori social ku disa konsumatorë me të vërtet kanë vështirësi për t'i paguar faturat e tyre.
5. Një pjesë e konsumatorëve janë të përkatësisë minoritare serbe, kryesisht të Mitrovicës veriore dhe ata fare nuk paguajnë, ndërsa për prodhimin e ujit që ata shfrytëzojnë kompania e ujësjellësit ka kosto të lartë.

Raporte të ndryshme tregojnë se faktori 4 nuk është gjithëpërfshirës; dhe sipas pikëpamjes së përgjithshme duket se faktori 3 dhe 5 janë kontribuesit kryesorë, ndërsa faktori 2 më shumë është si justifikim sesa si një arsye e vërtetë. Pa marrë parasysh arsyet, normat e ulëta të inkasimit nuk mund të vazhdojnë të tolerohen në këtë mënyrë.

Andaj, rritja e të hyrave është e një rëndësie të veçantë për këto NP, më shumë për shkak të nevojave të mëdha për investime kapitale. Për shembull, në Prishtinë, projektet që do të financohen nga KfW, KE dhe USAID arrijnë totalin prej 57 milionë Euro për të reduktuar rrjedhjet e ujit dhe fabrikën e ujit në Shkabaj dhe planifikohet të përfundojë deri më 2015. Një punë e tillë është esenciale duke pasur parasysh shkallën e humbjeve të ujit dhe parashikimet e nevojshme të rritjes së prodhimit të ujit për 50% për dhjetë vitet e ardhshme për të përmbushur rritjen e kërkesës së ujit në Prishtinë.



Përveç përkrahjes buxhetore nga Qeveria, sektori i ujit përkrahet edhe nga agjencionet e jashtme, duke përfshirë Komisionin Evropian, KfW, Agjencionin Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim, dhe USAID.

Megjithatë, duke shikuar në të ardhmen e Kosovës dhe hyrjen eventuale të saj në Bashkimin Evropian, nevojat për investime do të jenë edhe më të mëdha sesa që aktualisht theksohen. Kosova duhet t'i përmbushë direktivat e KE-së për ujë dhe mbeturina (e cila përfshinë, p.sh. kërkesat për trajtimin e impianteve të ujerave të zeza për çdo 10,000 banorë). Kosova nuk do të jetë në gjendje t'i përmbushë kërkesat për investime kapitale (të cilat me siguri do të jenë me miliarda euro) dhe do të jetë e varur nga disa kontribute financiare (substanciale) nga BE-ja. Mirëpo, edhe konsumatorët duhet të kontribuojnë në këtë drejtim.

KfW në vitin 2010 ka investuar studimin e fisibilitetit për projektet e impianteve të ujërave të zeza për qytetin e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit, si dhe është e gatshme që të investojë në periudhën afatshkurtër shumë prej 12 milion Euro, ndërsa kjo vlerë pritet të shumëfishohet në periudhë afatmesme.

Komisioni Evropian ka investuar në një impiant të ujërave të zeza në Skenderaj dhe ky projekt do të finalizohet në vitin 2011.

Nevojitet të bëhet një realizim i gjerë i shkallës së investimeve që kërkohen në sektorin e ujit. Investimet nuk nevojiten vetëm për t'i përmbushur kërkesat e UE-së; ato nevojiten për t'i përmbushur kërkesat e rritura për më shumë ujë dhe kualitet më të mirë të ujit, prej të cilave varet shëndeti i popullatës dhe zhvillimi ekonomik i vendit.

Popullata duhet të jetë në dijeni që ekzistojnë rreziqe substanciale në furnizim me ujë në Kosovë dhe që mungesa e menaxhimit të harxhimit të ujit bartë rrezik për ujin e pijshëm dhe për natyrën në përgjithësi. Mirëpo, përkundër kufizimeve ekzistuese, NP-të duhet të jenë sa më efikase që është e mundur.



Kompania Rajonale e Ujësjetës Prishtina (KRU Prishtina)

<i>Numri i regjistrimit</i>	70433736
<i>Emri i regjistrimit</i>	Kompania Rajonale e Ujësjetës Prishtina sh.a. (KRU Prishtina)
<i>Data e inkorporimit</i>	29.05.2007
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Kosovë Prishtinë, Rr. TahirZajmi
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€ (i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Ejup Hashani Bajram Jashari Adem Duriqi Kujtim Xhelili
<i>Kryesuesi</i>	Ejup Hashani
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	SkënderBublaku
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Naim Mujaj
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Enes Mehmeti
<i>Takimet e bordit</i>	10 takime gjatë vitit 2010
<i>Formimi i Komiteteve të Bordit</i>	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet</i>	10 takime gjatë vitit 2010
<i>Komitetet tjera</i>	
<i>Auditor(ët) i jashtëm</i>	Univerzum Audit
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	PCB, RFB, NLB, BPB, BE, dhe TEB

Hyrje e Pergjithshme për Funksonimin e KRU Prishtina në vitin 2010

KRU Prishtina mbulon me shërbimet e saj të furnizimit me ujë dhe kanalizime të ujërave të zeza 8 komuna me rreth 550 mijë banorë, që përbëjnë rreth 30% të popullsisë së vlerësuar të Kosovës. Kapaciteti aktual i furnizimit është 1,400l/s dhe sigurohet nëpërmjet 2 fabrikave për prodhimin e ujit.

Me qëllim të krijimit të shërbimit më cilësor për furnizim me ujë të qytetareve, Qeveria, Komuna, dhe donatorët si KfW dhe KE do të bashkëfinancojnë ndërtimin e fabrikës së re të ujit në fshatin Shkabaj.



Performanca Operative

Tabela 25 Performanca Operative në KRU Prishtina

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pafaturuar %	55%	54%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	81%	80%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	70%	65%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	1.19	1.06	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m ³)	0.10 €	0.14 €	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	5.65	5.75	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	65.64	32	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	0.80%	2.00%	Trend pozitiv
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	-	-	

Nga të dhënat e tabelës të mësipërme vërehet se KRU Prishtina ka shënuar arritje shumë pozitive gjatë vitit 2010, sidomos në treguesit operacionalë të cilësisë së ujit të ofruar, furnizimit më të mirë falë prodhimit më të lartë të ujit në kushtet e nivelit të njëjtë të humbjeve teknike e komerciale, ruajtjen e të njëjtit nivel faturimi me vitin 2009, rritjen e ndjeshme të nivelit të arkëtimit nga 65% në vitin 2009 në 70%. Kjo performancë është bërë falë një plani efektiv masash në menaxhimin e riskut të kreditimit, rritjes së efektivitetit të kontroleve të ushtruara, mundësimit të pagesave nëpërmjet bankave të nivelit të dytë dhe Western Union, rritjen e qenësishme të numrit të konsumatorëve, si dhe masës së faturimit me ujëmatës.

Këta tregues dëshmojnë për një punë të vazhdueshme dhe serioze të drejtuesve të ndërmarrjes në vendosjen dhe zbatimin e politikave dhe procedurave në funksion të mirë menaxhimit të burimeve të shoqërisë.



Performanca Financiare

Tabela 26 Performanca Financiare në KRU Prishtina

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të hyrat Operative	10,732,527	9,970,073
Të hyrat nga shërbimet e furnizimit me ujë	777,968	106,162
Të hyrat tjera operative	88,343	49,949
Të hyrat nga grantet		
Totali i të hyrave operative	11,598,838	10,126,183
Shpenzimet operative		
Uji i blerë me shumicë	-75,030	-81,994
Shpenzimet e energjisë	-1,857,142	-1,972,240
Shpenzimet e karburanteve	-92,747	-173,034
Shpenzimet e personelit	-3,085,368	-2,718,445
Shpenzimet material	-664,917	-488,814
Shpenzimet e jashtme kontraktuese	-453,691	-552,431
Shpenzimet e rekreacionit, ndihmave solitare etj	-36,034	-31,764
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimet	-113,351	-156,683
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	-3,846,054	-3,447,577
Shpenzimet e provizionit të borxhit të keq	-3,289,115	-2,819,699
Të dalat financiare	-36,995	-22,562
Total Shpenzimet Operative	-13,550,443	-12,465,153
Fitimi (Humbja) Operative	-1,951,605	-2,338,970
Të hyrat nga Interesi në Depozitat Bankare	11,671	7,880
Fitimi/Humbja para tatimit	-1,939,934	-2,331,089
(Humbja) Fitimi i vitit	-1,939,934	-2,331,089

Gjithashtu, edhe tabela e mësipërme paraqet se ndërmarrja ka arritur rezultate të mira financiare me rritje të ardhurash prej 15% nga viti 2009 dhe arritje prej 93% të buxhetit, përkundrejt rritjes së shpenzimeve me vetëm 3% nga viti paraardhës dhe realizim 98% të buxhetit të periudhës. Përfitimi i ndërmarrjes është rritur me 30% krahasuar me vitin 2009, ndërsa ka arritur 88% buxhetin agresiv të parashikuar.



Struktura e Stafit

Tabela 27 Struktura e Stafit në KRU Prishtina

KRU Prishtina	2010	2009
Nr. i punëtorëve (M)	451	447
Nr. i punëtorëve (F)	53	50
Nr i punëtorëve me përgatitje superiore	45	43
Nr i punëtorëve me përgatitje të lartë shkollore	32	32
Nr i punëtorëve me përgatitje të mesme shkollore	402	397
Nr i punëtorëve me përgatitje të ulët shkollore	25	25
Gjithsejtë	504	497

Gjithashtu edhe struktura e stafit prej 504 të punësuarve është meritore për ngritjen e trendëve të inkasimit të cilët me përkushtimin e tyre për mbledhjen e të hyrave arritën që të ngrisin nivelin e inkasimit.

Raportimet Ligjore

Raportimet tremujore të menaxhimit pranë bordit të drejtorëve janë kryer rregullisht dhe paraqitja e progresit të performancës operationale, komerciale, financiare dhe aktiviteteve organizative dhe atyre ligjore është diskutuar në bordi i drejtorëve e pas pranimit janë dorëzuar pranë NJPMNP. E njëjta procedurë ka ndodhur edhe për Planin e Biznesit 2010 dhe Raportin Vjetor 2010. Mund të përmendet që cilësia e raportimeve tremujore ka ardhur në rritje pasi më së fundmi, analiza e treguesve operationale dhe financiarë nuk kryhet vetëm në krahasim me të njëjtën periudhë tremujore të vitit të kaluar, por edhe me caqet e miratuara të planit të buxhetit. Për sa i përket Raportit Vjetor, ai paraqet shpjegime të performancës operationale, financiare, organizative, investimeve etj; dokumenti përmban vetëm të dhëna të përzgjedhura operative e financiare, sipas formatit të ZRRUM-it.



Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Radoniqi (KRU Radoniqi)

<i>Numri i regjistrimit</i>	70433554
<i>Emri i regjistrimit</i>	Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Radoniqi” sh.a.-Gjakovë
<i>Data e inkorporimit</i>	24.11.2009
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Rr.UÇK-Gjakovë
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€ (i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Ruzhdi Këpuska Agim Gjoshi Hajdar Grezda Leonard Shehu
<i>Kryesuesi</i>	Ruzhdi Këpuska
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Albert Zajmi
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Kastriot Zhaveli
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Saranda Vehapi
<i>Takimet e bordit</i>	13 takime gjatë vitit 2010
Formimi i Komiteteve të Bordit	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet Komitetet tjera</i>	11 takime gjatë vitit 2010
<i>Auditori(ët) i jashtëm</i>	Audit&Conto
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	RFB, PCB, NLB, TEB, BPB



Hyrje e Përgjithshme për Funkcionimin e KRU Radoniqi - Gjakovë në vitin 2010

Mbulon me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm rajonin e Gjakovës, Rahovecit dhe Lumbardhës, me një popullsi me rreth 230.000 banorë. Ujërat merren nga liqeni i Radoniqit dhe lumi i Bistricës; aktualisht prodhohen 730 l/sec.

Performanca Operative

Tabela 28 Performanca Operative në KRU Radoniqi

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pafaturuar %	61%	55%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	93%	94%	Trend negativ
Shkalla e arkëtimit %	67%	69%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	0.95	1.02	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m ³)	0.1	0.12	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	7.9	8.01	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	46	59	Trend pozitiv
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	0.70%	0.70%	Trend i njëjtë
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	24	24	Trend i njëjtë

Ndër treguesit operacionalë, shoqëria ka ruajtur të njëjtën cilësi të ujit të ofruar, ka rritur cilësinë e shërbimit, dëshmuar nga numri më i ulët i ankesave teknike e komerciale, ka rritur eficiencën e shërbimit, dëshmuar në treguesin e koston më të ulët për njësi (m³ ujë), dhe ka rritur numrin e konsumatorëve edhe mbi buxhet. Sidoqoftë, 3 treguesit më të rëndësishëm operacionalë: humbjet në rrjet janë rritur nga 55% në 61%. Pra faturimi ka shënuar rënie prej 6%, ndërsa arkëtimi është zvogëluar me 2%, tregues këto që dëshmojnë nevojën e shoqërisë për t'i intensifikuar më tej masat në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrjetit shpërndarës me gjithë vështirësinë objektive, si edhe masat e kontrollit të lidhjeve të paligjshme dhe menaxhimit të riskut të kredisë.



Performanca Financiare

Tabela 29 Performanca Financiare në KRU Radoniqi

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të hyrat nga shitjet e ujit (Faturimi)	2,606	2,541
Të hyrat e tjera operative	188	104
Totali i të hyrave operative	2,795	2,645
Kostoja operative:		
Stafi	1,316	1,284
Mirëmbajtja	33	36
Energjia elektrike	145	139
Karburanti	41	44
Kemikalet	21	40
Marketingu	16	10
Administrata	26	25
Të tjera	315	207
Zhvleftësimi	770	753
Borxhet e këqija	615	665
Shpenzimet tjera Operative	315	207
Totali i kostos operative	3,303,453	3,207
Të Ardhurat nga Interesi	7,9	3,2
Neto Profiti / (Humbja)	-508	-561

KRU Radoniqi ka arritur rezultate përafërsisht të njëjta me 2009 me të ardhura pak më të rritura përkundrejt vitit 2009, dhe osto poashtu me të rritur dhe kjo me pastaj ka rezultua edhe me një humbje financiare në pak më të vogël se në vitin paraprak.



Struktura e Stafit

Tabela 30 Struktura e Stafit në KRU Radoniq

KRU Radoniq	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	196	192
Nr. i punëtoreve (F)	23	18
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	23	21
Nr i punëtoreve me përgatitje të lartë shkollore	10	9
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	133	133
Nr i punëtoreve me përgatitje të ulët shkollore	53	53
Gjithsejtë	220	217

Nga tabela e mësipërme vërehet se nga numri i tërësishëm i të punësuarve afër 15% të tyre janë me përgatitje të lartë e superiore ndërsa pjesa dominuese është me përgatitje të mesme shkollore.

Raportimet Ligjore

Raportimet tremujore janë kryer mirë nga menaxhimi i KRU, miratuar dhe paraqitur në kohë pranë NJPMNP. *Raportet* paraqesin me profesionalizëm e në mënyrë të standardizuar treguesit kryesore operacionale përkundrejt buxhetit dhe të njëjtës periudhë të vitit paraprak, pasqyrat financiare 3 mujore të shpjeguara me shënimet përkatëse, menaxhimin e riskut, kënaqësinë e konsumatorit etj. Vlen për t'u përmendur që KRUR bën raportet e kënaqësisë së klientit edhe në bazë 3mujore.

Raporti Vjetor është një mjet i mirë marrëdhëniesh me publikun dhe prezanton seriozitet të drejtuesve të ndërmarrjes.

Plani i Biznesit 2011 jep tregues të detajuar të performancës së shërbimit ndaj klientit, sistemit kontrollues dhe monitorimin e parametrave më kritik, planin e investimeve, plan-zhvillimin e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e performancës, programet e testimit të cilësisë së ujit, zhvillimin e administratës, kompjuterizimin dhe sistemin e informacionit të menaxhimit.

Drejtuesit duhet të marrin masa urgjente për zgjidhjen e problemeve të bartura në raportimin financiar, vendosjen e procedurave dhe zhvillimin e politikave përkatëse të kontabilitetit, prokurimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.



Kompanie Rajonale e Ujësjetës Hidromorava (KRU Hidromorava)

<i>Numri i regjistrimit</i>	70433937
<i>Emri i regjistrimit</i>	Kompania Rajonale e Ujësjetës "HidroMorava" Sh.a-Gjilan
<i>Data e inkorporimit</i>	09.12.2009
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Rr. ABordi i Drejtorëveullah Tahiri, Gjilan
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€ (i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Avdyl Hasani Azem Mujku Xhelal Selmani Elhame Shefkiu
<i>Kryesuesi</i>	Avdyl Hasani
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Myrvete Hoti
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Xhelal Shabani
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Rozelita Hasani
<i>Takimet e bordit</i>	10 takime gjatë vitit 2010
<i>Formimi i Komiteteve të Bordit</i>	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet Komitetet tjera</i>	10 takime gjatë vitit 2010
<i>Auditor(ët) i jashtëm</i>	Audit&Conto
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	RFB dhe NLB



Hyrje e Përgjithshme për Funkcionimin e KRU Hidromorava - Gjilan në vitin 2010

Kompania furnizon me ujë të pijshëm dhe ofron shërbime për ujëra të zeza në komunat e Gjilanit, Kamenicës dhe Vitisë. Ndërmarrja menaxhon ujësjellësin në regjionin e Gjilanit.

Performanca Operative

Tabela 31 Performanca Operative në KRU Hidromorava

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pafaturuar %	60%	57%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	79%	78%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	68%	63%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	1.12	0.9	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m ³)	0.08 €	0.15 €	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	8.3	8.9	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	150	122	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	1.30%	0.50%	Trend negativ

Ndërmarrja nuk ka pasur arritje pozitive në cilësinë e ujit gjatë vitit 2010 dhe rritjen e humbjeve teknike nga 57% në 60% të ujit; ndërsa ka disa tregues operacionale me arritje pozitive si: rritjen e arkëtimit nga 63% në 68%, eficiencën më të lartë në punë dëshmuar në rritjen e normës së mbulimit të punës, si edhe uljen e kostot për njësi.



Performanca Financiare

Tabela 32 Performanca Financiare në KRU Hidromorava

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të ardhurat operative	1,560	1,409
Të hyrat nga shitja	20	20
Të hyrat nga grantet	139	16
Totali i të hyrave operative	1,719	1,445
Kostoja operative:		
Stafi	612	587
Shpenzimet e borxhit të keq	405	-
Shpenzimet e Zyrës	15	20
Shpenzimet e Pagave	612	587
Shpenzimet e zhvlerësimit	684	490
Shpenzimet elektr. Derivatet & PTK	159	174
Shpenzimet tjera Operative	155	139
Mirëmbajtja	75	112
Total shpenzimet operative	-2105	-1522
Fitimi (Humbja) para tatimit	-386	-77
Tatimi në Fitim		
Neto Profiti (Humbja)	-386	-77

Për sa i përket performancës financiare, ndërmarrja ka pasur rritje të të ardhurave me 21%, përkundrejt vitit 2009, me mase së rritjes së shpenzimeve operative dhe sidomos shpenzimesh zhvlerësimi në krahasim me të vitit 2009. Për pasojë, rezultati operacional është në humbje me 209 mijë Euro më shumë se në vitin 2009.

Struktura e Stafit

Tabela 33 Struktura e Stafit në KRU Hidromorava

KRU Hidromorava	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	123	125
Nr. i punëtoreve (F)	19	18
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	18	19
Nr i punëtoreve me përgatitje të lartë shkollore	6	6
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	75	74
Përkatësia etnike (Të tjerë)	5	5
Gjithsejtë	142	143

Nga tabela e mesiperme shihet se nga te punësuarit prej 142 në KRU Hidromorava në Gjilan pjesa dominuese janë të gjinisë mashkullore apo 86% sikurse që dominon edhe përgatitja e mesme shkollore prej 52% përkundrejt përgatitjes superiore.



Raportimet Ligjore

Raportet tremujore janë paraqitur dhe miratuar në kohë nga bordi i drejtorëve, në përputhshmëri me LNP, por përmbajtja dhe struktura e tyre nuk është e standardizuar. Në raportin e tremujorit të parë përmban pasqyrat financiare dhe shpjegime narrative të aktiviteteve të menaxhimit; raporti i tremujorit të dytë paraqet pasqyrat financiare kumulative gjashtëmujore dhe jo të dhëna të veçanta për tremujorin; raporti i tremujorit të tretë paraqet pasqyrat financiare nëntëmujore, jo tremujore të veçuara, dhe raport narrativ për aktivitetet e bordi i drejtorëve dhe Menaxhimit. Raporti i tremujorit të katërt, i cili është paraqitur edhe si raport vjetor, përmban edhe informacion mbi aktivitetin e bordi i drejtorëve, KA, Menaxhimit, operacionet dhe paditë në Gjykatë, bashkë me prokurimet.

Sugjerohet të përdoret një format i standardizuar raportimi dhe të raportohen rezultatet financiare tremujore përkundrejt jo vetëm periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, por edhe buxhetit tremujor të vitit aktual. Vihet re përmirësim në cilësinë e raportimit me ardhjen e KF të ri, sidoqoftë mbetet që përmbajtja dhe struktura e këtyre raportimeve të standardizohet gjatë vitit në vazhdim.

Plani i Biznesit është i mirëstrukturuar, ka paraqitur rezultatet operacionale dhe përpjekjet e menaxhimit për të siguruar furnizim pa ndërprerje, planifikon rritje me 8,867 konsumatorë të rinj. Ka Plan Veprimi për vitin 2011 lidhur me strukturën organizative, rekrutimin dhe trajnimin, si edhe përfundimin e vlerësimit individual të performancës, i cili është kryer pjesërisht gjatë vitit 2010. Në Planin e veprimi teknik përmendet numri i ujëmatësve që do të instalohet si edhe përdorimi i GIS që është vendosur kohë më parë. Përmendet, gjithashtu aktiviteti i mirëmbajtjes dhe leximit, i cili paraqet problem pasi mundësohet vetëm në bazë tremujore dhe faturat mujore lëshohen me mesatare të vlerësuar, për mangësi stafi, sipas shpjegimit të menaxhimit. Në këto dokumente kryesore të shoqërisë mungojnë parashikimet e rezultatit financiar për periudhën e buxhetuar.

Ndërmarrja duhet patjetër të përfshijë Pasqyrat Financiare të buxhetuara në çdo dokument të planit të biznesit, pasi ky është mjeti i vetëm planifikues dhe kontrollues i punës së menaxhimit dhe bordeve, që mundëson, gjithashtu transparencën ndaj Aksionarit dhe publikut në tërësi.

Drejtimesit e ndërmarrjes tregojnë angazhim të sinqertë në mbarëvajtjen e kompanisë, ndërsa përballen me sfida të menaxhimit operacional, organizativ dhe financiar të shoqërisë. Po bëhen përpjekje për ngritjen e një sistemi të kontrollit të brendshëm, ndërsa mbetet shumë për të arritur në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar dhe konsolidimin e procedurave të brendshme për ta siguruar ruajtjen e burimeve dhe mjeteve të shoqërisë. Bordi i drejtorëve shpreh angazhim shumë serioz në gjendjen e vështirë të shoqërisë, me gjithë mungesat në eksperiencat menaxheriale dhe të qeverisjes korporatave. Vlen të përmendet përkushtimi i veçantë i KA në respektueshmërinë e kuadrit ligjor dhe transparencën dhe arsyeshmërinë e vendimeve të bordi i drejtorëve.



Kompania Rajonale e Ujësjetës Hidroregjioni Jugor (KRU Hidroregjioni Jugor)

<i>Numri i regjistrimit</i>	70433702
<i>Emri i regjistrimit</i>	Kompania Rajonale e Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh.a.-Prizren
<i>Data e inkuorporimit</i>	01.12.2009
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Rr. Vatrës Shqiptare - Prizren
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€(i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Naser Bajraktari Duda Balje (në dorëheqje) Galip Hoda Bujar Hasani Drita Grazhda Sahit Ukaj
<i>Kryesuesi</i>	Naser Bajraktari
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Besim Baraliu
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Liman Gashi
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Ajshe Cikaqi
<i>Takimet e bordit</i>	13 takime gjatë vitit 2010
<i>Formimi i Komiteteve të Bordit</i>	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet</i>	15 takime gjatë vitit 2010
<i>Komitetet tjera</i>	Komiteti për Burime Njerëzore Komiteti për Investime Kapitale
<i>Auditor(ët) i jashtëm</i>	Audit&Conto
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	NLB, PCB, dhe BPB



Hyrje e Përgjithshme për Funkcionimin e KRU Hidroregjioni Jugor - Prizren në vitin 2010

Kompania e ujësjellesit rajonal Hidroregjioni Jugor, shërbimet e veta i ofron në pjesën jugore të Kosovës duke përfshirë këto komuna:

- Prizrenin
- Suharekën
- Dragashin
- Malishevën

Rrjeti furnizues që i kryen shërbimet përfshinë 4 njësi operacionale: Njësinë Prizren, Suharekë, Dragash dhe Malishevë. Furnizimi me ujë bëhet prej burimeve vetanake. Në nivel të kompanisë furnizohen edhe 22 fshatra që janë të kyçur në rrjetin e Kompanisë Regjionale Prizren, Suharekë, Malishevë. Numri i popullatës në të cilën Kompania e Ujësjesit Regional Prizren i kryen shërbimet e veta vlerësohet të jetë rreth 200.000.

Performanca Operative

Tabela 34 Performanca Operative

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pafaturuar %	58%	55%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	80%	79%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	69%	60%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.95	0.88	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m ³)	0.12 €	0.12 €	Trend i njejtë
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.38	6.05	Trend negativ
Ankesat për '000 kons	15	25	Trend pozitiv
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	9.00%	3.90%	Trend negativ
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	24	24	Trend i njejtë

Aktiviteti i shoqërisë ka pasur arritje jo të lavdërueshme në rënien e cilësisë së ujit dhe rritjen e humbjeve në rrjet (rënien e përqindjes së faturimit), ndërsa ka arritur rezultate pozitive në përmirësim të nivelit të arkëtimit, rritjen e numrit të konsumatorëve, rritjen e mbulimit të punës dhe efikasitetit.



Performanca Financiare

Tabela 35 Performanca Financiare në KRU Hidroregjioni Jugor

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të hyrat operative		
Të hyrat nga shitjet	2,806	2,733
Të hyrat nga grantet	47	23
Të hyrat tjera operative	55	
	2,908	2,756
(Shpenzimet) operative		
Shpenzimet e pagave	-1,096	-959
Shpenzimet e zhvlerësimit		
Asetet vetanake të rivlerësuar	-815	-808
Asetet donacion para 2009	-47	
Asetet donacion 2009 -2010	-73	-108
Total shpenzimet e zhvlerësimit	-935	-916
Energjia elektrike & karburantet	-601	-557
Shpenzimet tjera operative	-395	-354
Lejimet për borxhet e këqija dhe të Dyshimta	-414	-540
Total shpenzimet operative	-3,441	-3,326
Fitimi / (Humbja) para tatimit	-533	-570
Tatimi në fitim		
(Humbja)/Fitimi i vitit	-533	-570

Nga tabela e mësipërme shihet se edhe ndër treguesit financiarë, arritjet janë të pjesshme si për shembull: të ardhura janë rritur me 5% krahasuar me vitin 2009 dhe kanë arritur buxhetin e vitit, ndërsa shpenzimet kanë një rritje si rrjedhojë e rritjes së shpenzimeve të zhvlerësimit dhe shpenzimeve operative, duke shkaktuar kështu një rezultat financiar (humbje) me 9% më të ulët së viti 2009 .



Struktura e Stafit

Tabela 36 Struktura e Stafit në KRU Hidroregjioni Jugor

KRU Hidroregjioni Jugor	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	202	172
Nr. i punëtoreve (F)	18	17
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	18	14
Nr i punëtoreve me përgatitje të lartë shkollore	7	6
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	90	64
Nr i punëtoreve me përgatitje të ulët shkollore	105	105
Gjithsejtë	220	189

Nga tabela e mësipërme mund të shihet struktura profesionale, gjinore nga mund të shihet se vetem 11% nga të punësuarve kanë përgatitje të lartë e superiore profesionale ndërsa një numër i madh i të punësuarve që janë me përgatitje të ulët shkollore në të ardhmen duhet shikuar mundësinë e rikualifikimit të tyre.

Raportimet Ligjore

Raportet tremujore dhe ai vjetor janë përgatitur nga menaxhimi, shqyrtuar dhe miratuar në kohë nga KA dhe bordi i drejtorëve. Ato paraqiten cilësore në përmbajtje dhe strukturim/formë. Raporti Vjetor është shumë profesional, paraqet me detaje aktivitetin e ndërmarrjes, bordi i drejtorëve, KA dhe komitetet e tjera, si dhe të menaxhimit në nivel strategjik, duke shpalosur vizionin e tyre për rritje, operacionet, investimet, rezultatet operative dhe financiare; argumentohen me transparencë detajet e rezultateve dhe kontributet.

Plani i Biznesit gjithashtu i mirëshqyrtuar dhe aprovuar, është gjithashtu i detajuar në tregues dhe argumentues në caqet financiare, operacionale, organizative dhe burimet njerëzore për t'u arritur, pra vizioni dhe strategjia më afatgjate përputhen arsyeshëm me planin konkret të veprimeve gjatë periudhës. Vetëm ndonjë prej shumë objektivave mund të mos ketë nivel të caktuar/matshëm objektiv i në sasi dhe afat kohor, por shumica e tyre i kanë. Mund të konsiderohet një dokument i mirë për ta udhëhequr aktivitetin njëvjeçar të NP-së.

Bordi i Drejtorëve i kësaj ndërmarrje është aktiv dhe vihet re një rritje e nivelit të disiplinës, vendosjes dhe zbatimit të procedurave të kontrollit të brendshëm që ka nisur të tregojë frytet e saj. Ndërsa ky bordi i drejtorëve duhet mbështetur në vijueshmërinë e aktivitetit të tij dhe projekteve të ndërmarrja në organizimin strukturor, rritjen e aktivitetit dhe përfitueshmërisë, si edhe mirë menaxhimin e projekteve të rëndësishme të investimit falë angazhimit dhe nivelit të mirë profesional dhe respektueshmërisë së treguar në kërkesat e ligjit mbi NP. Mbetet punë për t'u bërë në zgjidhjen e problemeve të bartura me raportimin financiar dhe procedurat përkatëse.



Kompania Rajonale e Ujësjiellit Drini i Bardhë (Pejë)

<i>Numri i regjistrimit</i>	70465032
<i>Emri i regjistrimit</i>	Kompania Rajonale e Ujësjiellit “Drini I Bardhë” Sh.a-Pejë
<i>Data e inkuorporimit</i>	1 Shkurt 2008
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Mbretëresha Teutë nr. 85, Pejë
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€(i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Ali Sefaj Fadil Kabashi Beqir Metaje Shkodran Gaxherri
<i>Kryesuesi</i>	Ali Sefaj
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Milazim Shatri
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Dan Muçkurtaç
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Gjergj Gjekaj
<i>Takimet e bordit</i>	10 takime gjatë vitit 2010
Formimi i Komiteteve të Bordit	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet</i>	8 takime gjatë vitit 2010
<i>Komitetet tjera</i>	
<i>Auditori(ët) i jashtëm</i>	BU-Partners
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	NLB dhe PCB



Hyrje e Përgjithshme për Funkcionimin e KU Drini i Bardhë - Pejë në vitin 2010

Kompania Rajonale e Ujësjetës Drini i Bardhë (KRU Drini i Bardhë) fokus të aktivitetit të saj ka shërbimin e furnizimit me ujë për ujitje, kryesisht fermerëve në ngastrat e tyre të kultivuara me bimë bujqësore. Ndërmarrja përbëhet nga tri njësi punuese: ajo e Pejës, Gurakocit dhe Deçanit.

Performanca Operative

Tabela 37 Performanca Operative në KRU Drini i Bardhë

	2010	2009
Ujitja e tokave në ha	2760	2142

Nga tabela e mësipërme shihet se falë aktiviteteve të investimeve ka një rritje të tokave në hektar si të ujitura, ashtu që nga 2142 ha të ujitura në vitin 2009, në vitin 2010 janë ujitur 2760 ha apo 618 ha më shumë.

Performanca Financiare

Tabela 38 Performanca Financiare në KRU Drini i Bardhë

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të hyrat operative		
Të hyrat nga shërbimet e ujitjes	32	36
Të hyrat nga grantet	68	80
Të hyrat tjera operative	70	58
	170	174
Zbritur: Shpenzimet		
Zhvlerësimi	79	84
Kostoja e stafit	139	129
Shpenzimet tjera operative	19	24
Humbja dhe shitja e pajisjeve	7	
Fitimi (Humbja) para tatimit	-73	-63
Shpenzimet e tatimit në fitim		
Fitimi (Humbja) për vitin	-73	-63

Është ndërmarrja me performancën më problematike, ku të ardhurat e vitit 2010 në total janë pothuaj të njëjta si ato të vitit 2009, por shpenzimet patën një rritje të lehtë. Ky kombinim rezultoi në një humbje financiare për 10 mijë Euro më shumë se në vitin paraprak. Ndërmarrja përballet me një sërë sfidash tepër serioze për ekzistencën e saj dhe qëndrueshmërinë financiare sepse ka probleme me inkasimin e mjeteve për shërbimet e ujitjes për tokat bujqësore.



Struktura e Stafit

Tabela 39 Struktura e Stafit në KRU Drini i Bardhë

KUR Drini I Bardhë	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	39	36
Nr. i punëtoreve (F)	6	7
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	8	7
Nr i punëtoreve me përgatitje të lartë shkollore	3	2
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	24	24
Nr i punëtoreve me përgatitje të ulët shkollore	9	9
Gjithsejtë	45	43

Nga tabela e mësipërme shihet se kjo ndërmarrje ka një numër të vogël të të punësuarve. Kjo ndërmarrje ka gjithsejtë 45 punëtorë. Nga ky numër, 24% kanë përgatitje të lartë e superiore profesionale.

Raportimet Ligjore

Raportet tremujore dorëzohen tek NJPMNP kryesisht me kohë edhe pse jo shumë mirë të ristrukturuara, paraqesin një realitet me të dhëna financiare për periudha të caktuara.

Plani i Biznesit punohet dhe miratohet nga bordi në afatet e caktuara ligjore ndonëse ka hapësirë që ky plan i biznesit të jetë më përmbajtësor dhe me analiza më të thukshme të planifikimit biznesor por të jetë edhe me afatgjatë.



Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Radoniqi - Dukagjini (KRU Radoniqi - Dukagjini)

<i>Numri i regjistrimit</i>	70465161
<i>Emri i regjistrimit</i>	Kompania Rajonale e Ujësjetllësit "Radoniqi-Dukagjini" Sh.a.-Gjakovë
<i>Data e inkuorporimit</i>	05.12.2009
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Gjakovë- Kosovë
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€ (i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Canë Delija Avdullah Kryeziu Ismet Neziri Artan Nimani
<i>Kryesuesi</i>	Canë Delija
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Jahja Kadriu
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Luljeta Morina
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Lumnije Këpuska
<i>Takimet e bordit</i>	12 takime gjatë vitit 2010
<i>Formimi i Komiteteve të Bordit</i>	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet</i>	10 takime gjatë vitit 2010
<i>Komitetet tjera</i>	Komisioni për Lobim dhe Performancë
<i>Auditori(ët) i jashtëm</i>	Audit&Conto
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	NLB dhe RFB



Hyrje e Përgjithshme për Funkcionimin e KRU Radoniqi - Dukagjini në vitin 2010

Kjo ndërmarrje është themeluar në vitin 2003 nga AKM-ja me rastin e riorganizimit të sektorit të ujërave, duke e ndare njësinë punuese të ujitjes nga ndërmarrja shoqërore Hidrosistemi Radoniq dhe të njëjtën duke e bashkuar me ndërmarrjen shoqërore Dukagjini nga Prizreni, me emër të përbashkët.

Kompania Rajonale e Ujitjes “Radoniq-Dukagjini” (KRU Radoniq Dukagjini), ka selinë qendrore në Gjakovë. Më 1 janar 2008 ka filluar të funksionojë si Shoqëri Aksionare me aktivitet kryesor ofrimin e shërbimeve në shpërndarjen e ujit për ujitjen e tokave bujqësore.

Performanca Operative

Ndër treguesit operacionalë, shoqëria ka shërbyer me ujitje sipërfaqe më të vogla të mbjella gjatë vitit 2010 (shpjeguar me rritjen e reshjeve gjatë këtij viti), ndonëse ka rritur sasinë e ujit për furnizim (ndoshta falë rritjes së masës së humbjeve në rrjet). Ndërkaq, shkalla e inkasimit është rritur në 60% nga 52% të vitit 2009

Performanca Financiare

Tabela 40 Performanca Financiare në KRU Radoniqi – Dukagjini

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të hyrat operative		
Të hyrat nga shërbimet e ujitjes	527	484
Të hyrat nga grantet (rezervimet)	231	219
Të hyrat e tjera operative	52	57
Totali i të hyrave	810	760
Minus shpenzimet operative		
Kostoja e stafit	-286	-270
Zhvlerësimi	-257	-250
Lejimet për borxhe të këqija dhe të dyshimta	-238	-209
Shpenzimet tjera operative	-58	-62
Totali i shpenzimeve	-839	-791
Humbja/Fitimi para tatimit	-29	-31
Shpenzimet e tatimit në fitim/humbje		
Humbja/fitimi për vitin	-29	-31

Nga tabela shihet se të ardhurat kanë pësuar rritje nga viti 2009, por që edhe shpenzimet kanë pasur një rritje dhe kjo ka rezultuar me një humbje kryesisht të njëjtë si në vitin 2009 apo për 2 mijë Euro me pak.



Struktura e Stafit

Tabela 41 Struktura e Stafit në KRU Radoniqi - Dukagjini

KUR Radoniqi - Dukagjini	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	62	62
Nr. i punëtoreve (F)	4	4
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	8	8
Nr i punëtoreve me përgatitje të lartë shkollore	3	3
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	24	24
Nr i punëtoreve me përgatitje të ulët shkollore	9	9
Gjithsejtë	66	66

Nga tabela shihet se nga numri i tërësishëm prej 66 i të punësuarve, afër 17% kanë përgatitje të lartë e superiore profesionale ndërsa dominojnë te punësuarit nga gjinija mashkullore.

Raportimet Ligjore

Raportet tremujore janë përgatitur zakonisht në kohë, raportet tremujore të 3-të e të 4-të paraqesin edhe shpjegime narrative për aktivitetet e bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit, sidomos ai i fundvitit që përfshin edhe informacion mbi aktivitetin e bordi i drejtorëve, KA, Menaxhmentit, operacioneve dhe padive në Gjykatë, së bashku me prokurimet. Me gjithë përpjekjet e mira që janë bërë, vihet re mungesa e një standardi format të raportimit dhe këshillohet raportimi në bazë tremujori.

Plani i Biznesit ka strukturë të mirë, megjithatë financiarisht do të duhej një analizë me e thuket mbi burimet e investimeve të parapara dhe planifikimet për rritjen e inkasimit të të hyrave nga ujitja e tokave bujqësore.

Ndërkaq, raportimet mujore të KE dhe KF në bordi i drejtorëve janë të rregullta dhe paraqesin performancë operacionale dhe financiare krahasuar me buxhetin dhe periudhën paraardhëse 2009, si dhe aktivitetet dhe angazhimin e drejtuesve në zgjidhjen e problemeve; duket se ka qasje proaktive dhe profesionale në raportime.

Bordi i drejtoresve i kësaj ndërmarrje është i përgatitur teknikisht dhe shumë i motivuar në angazhimin për mbarëvajtjen e saj, dhe ka përcjellë respektueshmëri të kërkesave të Ligjit mbi NP.



Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Hidrodrini (KRU Hidrodrini)

<i>Numri i regjistrimit</i>	70433918
<i>Emri i regjistrimit</i>	Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Hidrodrini ” Sh.a.- Pejë
<i>Data e inkuorporimit</i>	23.12.2009
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Rr.Gazmend Zajmi 5, 3000 Pejë- Kosovë
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€(i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Shkelzen Hyseni Gjelosh Gojani Elez Hajdari Rexhë Abazi
<i>Kryesuesi</i>	Shkëlzen Hyseni
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Agron Tigani
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Rasim Maloku
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Ferasete Alija
<i>Takimet e bordit</i>	12 takime gjatë vitit 2010
Formimi i Komiteteve të Bordit	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet</i>	11 takime gjatë vitit 2010
<i>Komitetet tjera</i>	
<i>Auditori(ët) i jashtëm</i>	Audit&Conto dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	BE, BPB, PCB, RFB, dhe NLB



Hyrje e Përgjithshme për Funkcionimin e KRU HidroDrini - Pejë në vitin 2010

Kompania ka tre njësi operative të saj në Klinë, Junik, dhe Istog dhe veprimtaria primare e ndërmarrjes dhe filialeve të saj është grumbullimi, pastrimi dhe shpërndarja e ujit. Disa tregues kryesorë të performancës operative të ndërmarrjes janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Performanca Operative

Tabela 42 Performanca Operative në KRU Hidrodrini

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pafaturuar %	72%	74%	Trend pozitiv
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	85%	85%	Trend i njëjtë
Shkalla e arkëtimit %	59%	60%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	1.09	1.03	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m ³)	0.05 €	0.05 €	Trend i njëjtë
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	5.51	5.7	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	80	58	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	8.40%	8.30%	Trend negativ
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	24	24	Trend i njëjtë

Treguesit operacionalë kanë pasur arritje të pjesshme gjatë vitit 2010, kështu cilësia e ujit të pijshëm ka mbetur pak a shumë e njëjtë, faturimi ka qenë 2% më i lartë se viti 2009 që tregon se ka humbje të madhe të ujit prej 72%, derisa arkëtimi 1% më i ulët se viti i kaluar. Gjithashtu, numri i konsumatorëve ka pësuar rritje.



Performanca Financiare

Tabela 43 Performanca Financiare në KRU Hidrodrini

	Shpenzimet	Shpenzimet	Ndryshimi
	2010	2009	2010/2009
Të hyrat nga shitja	2,508,679	2,290,485	218,194
Të hyrat nga grantet	92,406	203,191	-110,785
Të hyrat tjera operative	180,831	67,045	113,786
Të hyrat nga grantet për blerjen e asetëve	221,138	-	221,138
I. Gjithsej të hyrat	3,003,054	2,560,721	442,333
Shpenzimet e pagave	908,575	832,016	76,559
Mirëmbajtja dhe riparimet	119,229	114,091	5,138
Energjia elektrike	339,443	311,342	28,101
Shpenzimet e derivateve	51,823	43,561	8,262
Provizioni për borxhet e këqija	599,542	639,311	-39,769
Shpenzimet e kemikaleve	9,996	10,356	-360
Shpenzimet e jashtëzakonshme	12,248	37,156	-24,908
Shpenzimet tjera operative	97,160	130,960	-33,800
Shpenzimet e zhvlerësimit	1,100,822	1,019,423	81,399
II. Gjithsej Shpenzimet	3,238,838	3,138,216	100,622
Fitimi/ (Humbja) para tatimit	-235,784	-577,495	-341,711
Tatimi në fitim	-	-	-
Fitimi (Humbja) e viti	-235,784	-577,495	-341,711

Për sa i përket treguesve financiarë, ndërmarrja ka gjeneruar të ardhura 9% më të larta në vitin 2010, përkundërt viti 2009, nga ana tjetër shpenzimet operationale kanë qenë 7% më të larta nga viti paraardhës, fakt ky qe ka shkaktuar një rezultat financiar (humbje) por që është më e vogël se në vitin paraprak për 341 mijë Euro se në vitin 2009.



Struktura e Stafit

Tabela 44 Struktura e Stafit në KRU Hidrodrini

KRU Hidrodrini	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	160	161
Nr. i punëtoreve (F)	19	19
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	14	14
Nr i punëtoreve me përgatitje të lartë shkollore	8	8
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	72	73
Nr i punëtoreve me përgatitje të ulët shkollore	85	85
Gjithsejtë	179	180

Nga tabela vërehet se numri i tërësishëm i stafit është 179 të punësuar nga të cilët vetëm 10 janë të gjinisë femerore ndërsa nga struktura profesionale vetëm 13% janë me përgatitje të lartë e profesionale.

Raportimet Ligjore

Raportimet Tremujore. Pas komenteve ofruar nga komisioni i auditimit, bordi i drejtorëve ka aprovuar në kohë këto raporte. Ato janë formatuar në bazë të treguesve të performancës operacionale dhe financiare. Ndaj, përveç plotësimit të raporteve edhe me analizën e aktiviteteve të menaxhimit në organizimin e brendshëm, strukturë, burime njerëzore dhe sistemin e kontrollit të brendshëm, cilësisë së raportimeve, zyrës ligjore etj, menaxhimi duhet të zhvillojë edhe pasqyra të mirëfillta financiare për periudhën që parashikohet.

Bordit të Drejtorëve i nevojitet eksperiencë në qeverisjen korporative, ndonëse është përpjekur ta ndjekë në përgjithësi zbatimin e kërkesave të LNP, si dhe të angazhohet seriozisht në problemet kyçe të ndërmarrjes. Duket se nuk ka mirëkuptuar frymën e përgjegjshmërisë në mënyrën dhe masën e caktimit të shpërblimit, si dhe vlerësimin e performancën e tij.



Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Mitrovica (KRU Mitrovica)

<i>Numri i regjistrimit</i>	70433740
<i>Emri i regjistrimit</i>	Kompania Rajonale e Ujësjetllësit "Mitrovica" Sh.a-Mitrovicë
<i>Data e inkorporimit</i>	08.12.2009
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Rr.Bislim Bajgora - Mitrovicë
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€ (i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri</i> Fehmi Kajtazi Nysret Gërzhaliu Haki Maxhuni Remzi Sylejmani
<i>Kryesuesi</i>	Fehmi Kajtazi
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Faruk Hajrizi
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Muhamet Salihu
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Zejnullah Mehaj
<i>Takimet e bordit</i>	20 takime gjate vitit 2010
Formimi i Komiteteve të Bordit	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet</i>	14 takime gjatë vitit 2010
<i>Komitetet tjera</i>	Komiteti për Mbikëqyrje të Furnizimit me Ujë Komiteti për Mbikëqyrjen e Humbjes së Ujit
<i>Auditori(ët) i jashtëm</i>	ETIKA-Prishtinë
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	NLB, RFB, dhe BPB



Hyrje e Përgjithshme për Funkcionimin e KRU Mitrovica në vitin 2010

Kompania Rajonale Ujësjellësit “Mitrovica” Sh.a. (KRUM) ofron shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mirëmbajtjes së kanalizimeve të ujërave të zeza edhe në pjesën veriore të Kosovës dhe mbulon këto komuna: Mitrovicën, Vushtrrinë, Skenderaj dhe Mitrovicën. Popullata e shërbyer vlerësohet të jetë rreth 300.000 banorë. Kapaciteti optimal prodhues i tanishëm sillet rreth $Q=520$ l/s ose rreth 16.5 milionë m^3 /vit. KRU Mitrovica operon Fabrikën për trajtimin e ujit në periferi të qytetit. Uji i papërpunuar merret nga kanali i Ibër Lepencit në vendbanimin e quajtur Lushtë ku edhe gjendet Stacioni i Pompave që e shtyn ujin deri në impiantin e trajtimit të ujit në Shipol në një gjatësi prej rreth 800m dhe në lartësi prej rreth 33m. Ndërmarrja ka një sërë stacionesh të pompave dhe rezervuarë të ujit, rrjeta të ujit dhe rrjeta të kanalizimit.

Performanca Operative

Tabela 45 Performanca Operative në KRU Mitrovica

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pafaturuar %	53%	51%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	56%	51%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	55%	51%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.65	0.67	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m ³)	0.1	0.1	Trend i njëjtë
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	10.26	10.27	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	1.2	-	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	2.40%	2.40%	Trend i njëjtë
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	20	-	

KRU Mitrovica nuk ka pasur arritje shumë pozitive në treguesit e saj operacionale gjatë vitit 2010: ka siguruar të njëjtën cilësi të ujit të pijshëm, ka faturuar 2% më pak të ujit të furnizuar, në krahasim me vitin 2009, apo ka humbje të ujit prej 53%, ndërsa arkëtimi ka shënuar rritje prej 4% nga periudha paraardhëse.



Performanca Financiare

Tabela 46 Performanca Financiare në KRU Mitrovica

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të hyrat operative:		
Të ardhurat nga shitjet	2,509	2,554
Të ardhurat tjera operative	107	134
Të ardhurat nga subvencionet e grantet	632	616
Gjithesejt të hyrat :	3,248	3,304
Shpenzimet operative :		
Shpenzimet e pagave	(987)	(925)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(1,781)	(1,778)
Kostoja e energjisë elektrike	(382)	(360)
Kostoja e komunikimeve	(7)	(8)
Kostoja e riparimeve dhe mirëmbajtjeve	(38)	(83)
Shpenzimet tjera operative	(435)	(432)
Totali i shpenzimeve operative	(3,630)	(3,586)
Fitimi (humbja) para tatimit	(382)	(282)
Tatim në fitim	-	-
Fitimi (humbja) neto	(382)	(282)

Tabela e mësipërme tregon se ndërmarrja ka një humbje financiare vjetore prej 382 mijë Euro e që në fakt është një përkeqësim në krahasim me vitin paraprak, Por duhet marrë parasysh se ndërmarrja ballafaqohet perveq tjerave edhe me kostot e mëdha peri ujin e disribuar në pjesën veriore të lumit Ibër e që në fakt nuk inkasohet nga minoritetet.

Struktura e Stafit

Tabela 47 Struktura e Stafit në KRU Mitrovica

KRU Mitrovica	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	211	211
Nr. i punëtoreve (F)	9	9
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	19	19
Nr i punëtoreve me pergatitje të lartë shkollore	5	5
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	85	85
Nr i punëtoreve me përgatitje të ulët shkollore	111	111
Gjithsejtë	220	220

Nga tabela shihet se numri i tërësishëm është 220 të punësuar dhe dominon punësimi nga gjinia mashkullore ndërsa 10% nga të punësuarit kanë përgatitje të lartë e superior profesionale.



Raportimet Ligjore

Raportet tremujore përmbajnë procesverbalet e bordit të drejtorëve dhe tabela të dhënash operative dhe financiare me shpjegim narrativ për punën e menaxhimit, aktivitetet operationale, investuese dhe organizative, menaxhimin e riskut, marrëdhënien me klientin dhe palë të treta; dhe nuk krahasohen të dhënat tremujore me buxhetin dhe periudhën paraardhëse.

Raporti Vjetor i vitit 2010 mund të jetë më gjithëpërfshirës e që në të do të përfshihej një përmbledhje e analizë dhe sintezë të proceseve në ndërmarrje.

Plani i Biznesit 2010 është më i mirë strukturuar dhe paraqet bilancet 2011-2014 të argumentuar me bazën e vlerësimit/parashikimit dhe jepen tabela të shumta.

Është ndërmarrje me performancë relativisht më të dobët mes ndërmarrjeve të tjera për një mori arsyesh objektive (rastet e shumta sociale, siç është mospagesa nga minoriteti Serb në zonën e Mitrovicës e të tjera)



Ndërmarrja Hidro Ekonomike Ibër Lepenc (Ibër Lepenc)

<i>Numri i regjistrimit</i>	70465157
<i>Emri i regjistrimit</i>	Ndërmarrja HidroEkonomike "Ibër Lepenc" Sh.a (IL)
<i>Data e inkomporimit</i>	31.12.2007
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Rruga Bill Clinton Nr.13, Prishtinë
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€(i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Nazmi Zenelaj Ilmi Ahmeti Faton Gyshnica Murat Meha Bajram Mustafa Gjelosh Vataj
<i>Kryesuesi</i>	Nazmi Zenelaj
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Hajdar Beqa
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Sheremet Smakolli
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Bajram Jashari
<i>Takimet e bordit</i>	11 takime gjate vitit 2010
<i>Formimi i Komiteteve të Bordit</i>	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet</i>	11 takime gjatë vitit 2010
<i>Komitetet tjera</i>	Komiteti për Marrëdhënie me KEK Komiteti për Projekte Kapitale Komiteti për Asete Komiteti për Akte Normative
<i>Auditori(ët) i jashtëm</i>	Univerzum Audit, Prishtinë
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	BE,BKT,TEB, dhe BPB



Hyrje e Pergjithshme për funksionimin e HS Ibër Lepenci në vitin 2010

HS “Ibër-Lepenc”-i si ndërmarrje publike hidroekonomike merret me shfrytëzimin dhe operimin e sistemit shumëfunktional për furnizim me ujë. Mjeti kryesor i ndërmarrjes është Diga në liqenin Ujman, e cila mundëson akumulimin e ujit i cili përdoret për prodhimin e energjisë elektrike, furnizimin e industrisë me ujë të papërpunuar për ftohje (KEK – termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”, Ferronikeli, dhe Trepça), ujësjellësit regjional në Mitrovicë dhe Prishtinë dhe furnizimin e bujqësisë me ujë për ujitje.

Sipas draft raportit të Bankës Botërore (Kosova - drejt Planit të Veprimit për Strategjinë e Ujit: Vlerësimi i kërkesës dhe ofertës së ujit dhe fizibiliteti i Skemës IbërLepenci Jugor, 10 Nëntor 2009) stacioni hidroelektrik i pendës dhe ai i bashkuar janë në gjendje të sigurt, por kanali transferues ka defekte nga shkalla e lartë e rrjedhjeve që vlerësohen të jenë rreth 50%. Raporti vazhdon më tutje duke thënë “Pas përmirësimeve në rezervuar dhe riparimeve të kanalit për të reduktuar rrjedhjet, rezervuari ka potencialin të përmbushë kërkesat e rritura në të gjithë sektorët dhe në veçanti kërkesat e rritura për ujë nga termocentrali Kosova e Re dhe kërkesat e rritura për furnizim me ujë për fabrikën e re në Prishtinë.

Performanca Operative

Tabela 48 Performanca Operative në NH Ibër Lepenc

	Uji i furnizuar në 000 m ³	Energjia e gjeneruar dhe e shitur në MW/h
2009	19.902.672	88,668
2010	33.673.968	115,429

Nga tabela vërehet për tregues pozitiv të performances ashtu që është mundësuar furnizimi me ujë në m³ për 41% më shumë se në vitin 2009, është gjenerua energji nga liqeni I Ujmanit për poashtu afër 76% më shume se në vitin paraprak dhe këto janë rezultate inkurajuese.

Performanca Financiare

Table 49 Performanca Financiare në NH Ibër Lepenc

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të hyrat operative		
Të hyrat nga shërbimet e ujitjes	4.451.198	3.379.084
Të hyrat nga grantet (rezervimet)	21.560	32.844
Të hyrat tjera operative	905.295	131.117
Totali I te hyrave	5.378.780	3.563.171
Minus shpenzimet operative		
Kostoja e stafit	-2.462.113	-2.090.434
Zhvlerësimi	-4.415.121	-4.482.743
Shpenzime tjera	-243.957	-178.865
Shpenzimet tjera operative	-491.372	-355.436



Totali I shpenzimeve	-7,712,563	-7,107,478
Humbja/Fitimi para tatimit	-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim/humbje		
Humbja/Fitimi për vitin	-2.333.783	-3.544.307

Nga tabela e mësipërme që tregon performancën financiare të HS Iber Lepenc vërehet se kemi rritje të hyrave të tërësishme për 34% në krahasim me vitin 2009 ndërsa ka edhe rritje të kostove operative që rrjedhin nga rritja e shërbimeve të ujitjes dhe që fitimi financiar përmbillet me 2.3 milion humbje apo për 35% humbje më pak se në vitin 2009.

Kjo humbje financiare është më shumë si rezultat i shpenzimeve të mëdha të zhvlerësimit nga kanalet e shumta të ujitjes, përndryshe kompania është financiarisht e qëndrueshme dhe financon projektet kapitale me mjete vetanake pa ndihme nga Qeveria apo donatorët.

Struktura e Stafit

Tabela 50 Struktura e Stafit në Ibër Lepenc

Ibër Lepenc	2010	2009
Nr. i punëtoreve (M)	211	182
Nr. i punëtoreve (F)	27	25
Nr i punëtoreve me përgatitje superiore	38	35
Nr i punëtoreve me përgatitje të lartë shkollore	5	4
Nr i punëtoreve me përgatitje të mesme shkollore	81	54
Nr i punëtoreve me përgatitje të ulët shkollore	114	114
Gjithsejtë	238	207

Nga tabela e mësipërme kuptohet që HS Iber Lepenc ka 238 të punësuar me dominim të të punësuarve të gjinisë mashkullore dhe me 18% të të punësuarve me përgatitje të lartë e superiore profesionale.

Raportimet Ligjore

Raportet tremujore janë të një cilësie të mirë profesionale në strukturë, përmbajtje e prezantim. Mbulojnë me shpjegime narrative, tabela, foto e grafikë aktivitetin operacional dhe financiar mujor e tremujor 2010 me krahasime përkundrejt vitit 2009 dhe periudhës së tremujoreve të PB 2010. Ka të dhëna të detajuara për investimet/prokurimet dhe statusin e tyre, burimet njerëzore, punën e departamentit të financës, AB, raportin e AJ, proceset gjyqësore, marrëdhëniet me institucionet qeveritare e private. Raportet japin bollshëm informacion me transparencë dhe saktësi, janë aprovuar nga bordi i drejtorëve dhe dorëzuar në kohë pranë NJPMNP.



Raporti Vjetor, miratuar në kohë nga bordi i drejtorëve, konsiderohet gjithashtu cilësor, paraqet përmbledhje, si edhe pasqyrë të detajuar të analizës e prezantimit të menaxhmentit e miratimit të bordit i drejtorëve të PF 2010, Raportin e AB që analizon performancën dhe rezultatin financiar 2010. Raportin e auditorit të jashtëm për vitin 2010, dhe raportin e performancës narrativ 2010. Bëhet analizë reale e çdo arritjeje, krahasim me 2009 dhe buxhetin 2010, analizohet çdo tejkalim e mosrealizim me argumente të detajuar dhe efektet operacionale e financiare. Rrjedhë logjikshëm dhe argumenton menaxhimin e sistemit të kontrollit të ndërmarrjes, si edhe faktorët e mjedisit të jashtëm ku ajo operon, analizohet në detaj çdo burim të ardhurash dhe shpenzimesh dhe arsyet e realizimit ose mosrealizimit.

Plani i Biznesit paraqet gjendjen e infrastrukturës dhe të mjeteve themelore, nuk jepen burimet financiare të planeve të investimit, si duket se argumentohet nevoja e shtimit të stafit me 24 punëtorë të rinj dhe 44 të tjerë sezonalë, si rrjedhë e kufizimeve të punës jashtë orarit të paraqitura me ligjin e punës. Plani i Biznesit bën një parashikim shumë konservator dhe aspak agresiv të mirë menaxhimit të burimeve të ndërmarrjes pasi për të siguruar 3.5% rritje në të ardhurat e aktivitetit parashikohet një shtesë prej 19% e shpenzimeve operacionale që rezulton në rënie të dukshme të fitimit operacional në 44% të rezultatit operacional të shoqërisë në vitin 2009 dhe një rezultat final me humbje 12% më të madhe. Plani i Biznesit paraqet gjendjen financiare për çdo njësi afariste.

Iber Lepenci paraqet performancë shumë pozitive të të gjithë treguesve operacionale dhe financiarë, fakt që ka sjellë ngritje në gjendjen e saj financiare. Rezultati përfundimtar financiar negativ vjen si rrjedhë e vlerës së madhe të shpenzimeve të zhvlerësimit nga asetete (kanalet e vjetëruara) e që kjo humbje ka pësuar rënie prej afër 30% në krahasim me 2009. Sidoqoftë, ndërmarrja duhet t'i rrisë më tej të ardhurat e saj për t'i optimizuar mundësitë e investimeve në rritje kapacitetesh prodhimi me burimet e saj të brendshme. Bordi i drejtorëve paraqet kompetencë profesionale dhe përfshirje serioze në udhëheqjen strategjike të shoqërisë, ndërsa me seriozitetin e tij ka kryer detyrimet fiduciare të aksionarit dhe respektuar kërkesat e Ligjit mbi NP.



Sektori i Mbeturinave

Kompania e Kosovës për Menaxhimin e Deponive është NP-ja e vetme qendrore në sektorin e mbeturinave; të gjitha të tjerat janë në pronësi të komunave përkatëse. Megjithatë, NJPMNP bashkëpunon me kompanitë e mbeturinave, sepse të gjitha ato pranojnë subvencione nga Qeveria. Këto NP kanë dy probleme të njëjta, sikurse sektori i ujërave: (a) investime të ulëta dhe (b) të hyra të ulëta për shkak të inkasimit të dobët. Ekziston një problem i vazhdueshëm, si t'i vetëdijësojmë njerëzit të paguajnë për shërbimet e mbeturinave; dhe ndryshe nga shërbimet e tjera komunale, mosvazhdimi i shërbimeve nuk e zgjedh këtë problem, por krijon probleme të reja. Aktualisht, kompanitë lokale të mbeturinave nuk janë në gjendje t'i paguajnë Kompanisë së Menaxhimit të Deponive të Kosovës (KMDK), andaj janë paraqitur vështirësi për t'i implementuar kontratat me kompanitë lokale.

Sikurse kompanitë e ujësjellësit edhe këto NP do të kenë nevojë për investime substanciale për të lëvizur nga situata e tanishme, ku nuk ka ndarje dhe riciklim të mbeturinave, në mënyrë që të përmbushen standardet e UE-së. IFC (Korporata Financiare Ndërkombëtare) është kontraktuar nga Ministria e Financave si këshilltar i transakcionit me qëllim të analizimit të gjendjes për ta futur kapitalin privat të investojë në atë publik, ndërsa disa agjencione të tjera kanë shprehur interesim në sektorin e mbeturinave, dhe si duket ka interesim të përfshihet edhe sektori privat. Megjithatë, komunat nuk e kanë përvojën që të merren me këto agjenci dhe me procesin e privatizimit, por për to ndihmesë është Njësia për Partneritet Publiko Privat (PPP) që vepron në kuadër të Ministrisë së Financave.



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë

<i>Numri i regjistrimit</i>	70324870
<i>Emri i regjistrimit</i>	Kompania për Menaxhimin e Deponive Kosovë (KMDK)
<i>Data e inkorporimit</i>	09.12.2005
<i>Adresa e regjistrimit</i>	Rruga Zija Shemsiu nr.23, Prishtinë
<i>Pronësia</i>	Republika e Kosovës (100%)
<i>Kapitali aksionar</i>	EUR 25,000€(i autorizuar, i lëshuar dhe plotësisht i paguar)
<i>Drejtorët</i>	<i>Emri dhe Mbiemri</i> Asllan Vitaku Naim Ferati Bajram Limani Makfire Osmani Isak Rakovica Eset Rama
<i>Kryesuesi</i>	Asllan Vitaku
<i>Kryeshefi Ekzekutiv</i>	Avni Ramadani
<i>Zyrtari Kryesor Financiar</i>	Iliriana Tahiri
<i>Sekretari i kompanisë</i>	Blerina Uka Bullatovci
<i>Takimet e bordit</i>	14 takime gjatë vitit 2010
Formimi i Komiteteve të Bordit	
<i>Komisioni i Auditimit</i>	
<i>Takimet</i>	11 takime gjatë vitit 2010
<i>Komitetet tjera</i>	Komiteti për Afrimin e Standardeve të Menaxhimit të Mbeturinave
<i>Auditor(ët) i jashtëm</i>	TrendBiz
<i>Llogaritë e fundit të audituara</i>	Fundi i vitit - 31 Dhjetor 2010
<i>Banka(t)</i>	PCB



Hyrje e Përgjithshme për Funkcionimin e KMDK-së në vitin 2010

Kompania e Kosovës për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) është NP-ja e vetme qendrore në sektorin e mbeturinave; të gjitha të tjerat janë në pronësi të komunave përkatëse. Megjithatë, NJPMNP bashkëpunon me kompanitë e mbeturinave, sepse të gjitha ato pranojnë subvencione nga Qeveria.

Performanca Operative

Tabela 51 Performanca Operative në KMDK

	2010	2009
Mbeturina të deponuara në 000 Ton	192	182

Nga të dhenat e sipërme shihet se kjo ndërmarrje ka deponuar në tonazh më të madhe të mbeturinave për 10 mijë tonë se sa në vitin 2009.

Deponitë janë të trashëguara nga administrimi ndërkombëtar ish AKM në gjendje shumë të përkeqësuar dhe vazhdimisht në praktik kemi problem me trajtimin e mbeturinave pasi kanë një kosto bukur të lartë, në anën tjetër KRM-të nuk inkasojnë në formë të duhur.

Performanca Financiare

Tabela 52 Performanca Financiare në KMDK

	31 Dhjetor 2010 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2009 (në EUR 000)
Të hyrat		
Të hyrat nga shitja	1,012,123	955,770
Të hyrat nga grandet	103,183	139,354
Të hyrat tjera operative	1,066	
Totali i të hyrave	1,116,373	1,095,123
Shpenzimet operative		
Shpenzimet e pagave	-267,335	-120,837
Shpenzimet e zhvlerësimit	-1,010,303	-855,286
Karburantet	-175,482	-31,834
Riparimi dhe mirëmbajtja	-182,507	-459,731
Lejimi për borxhet e këqija dhe të dyshimta	-73,913	-111,416
Shpenzimet tjera operative	-367,359	
Totali i shpenzimeve operative	-2,076,899	-1,579,104
Fitimi/(Humbja) para fitim	-960,526	-438,981



Struktura e Stafit

Tabela 53 Struktura e Stafit në KMDK

KMDK	2010	2009
Nr. i punëtorëve (M)	40	26
Nr. i punëtorëve (F)	6	4
Nr i punëtorëve me përgatitje superiore	6	3
Nr i punëtorëve me përgatitje të lartë shkollore	3	2
Nr i punëtorëve me përgatitje të mesme shkollore	36	24
Nr i punëtorëve me përgatitje të ulët shkollore	1	1
Gjithsejtë	46	30

Struktura e stafit shihet nga tabela me punësimin prej 46 te punësuarëve me dominim të gjinisë mashkullore dhe me afër 20% të të punësuarëve me përgatitje të larte e superiore profesionale.

Raportimet Ligjore

Raportet tremujore janë aprovuar dhe paraqitur në kohë pranë NJPMNP, këto raporte janë shumë të qarta, mirëstrukturuar dhe në mënyrë të përmblendhur informojnë për aktivitetin e NP nga niveli makro strategjik, ndryshimet në statusin operacional të NP, vendimet e bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit, ndryshimet në strukturën organizative, aktivitetet e kryera, qëllimet strategjike për tremujorët, treguesit kryesorë operacionalë e financiarë.

Raportet shprehin qëndrime të prera të bordit dhe kryeshefit ekzekutiv ndaj borxhlinjve dhe kërkojnë respektim të Marrëveshjeve të Mirëkuptimit për arkëtimin dhe riprogramimin e borxheve, në të kundërt vijojnë me ngritje padish në gjykatë.

Raporti Vjetor, i cili ka të njëjtën strukturë me raportet tremujore, përfshin përmblendhje dhe analizë të aktiviteteve të udhëheqjes së bordi i drejtorëve e menaxhmentit në të gjitha fushat, rezultatet organizative, operacionale, investimeve financiare të NP, si edhe paraqiten tregues operacionalë dhe financiarë të realizuar përkundrejt buxhetit 2010. PF 2010 nuk janë pjesë e raportit vjetor, por janë paraqitur më vonë me komente.

Bordi i drejtorëve, me gjithë përpjekjet e sinqerta, përballet me sfida të kompetencës menaxheriale, moseksperiencës në fushën e qeverisjes korporative, raportimit dhe menaxhimit financiar dhe mosfunksionim të mirë të ekipit ekzekutiv dhe rrjedhës së informacionit e vendimmarrjes mes tyre.